

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE

Fakulteti Juridik

STUDIME POSTDIPLOMIKE-MASTER

DREJTIMI PENAL



T E M A

“Shqiptimi i dënimit me burg-aspekte krahasimore në mes Gjykatës së Kërçovës dhe Gostivarit”

Mentori:

Prof.Dr:Ismail Zejneli

Kandidatja:

Shqipe Jusufi

Tetovë,2019

PËRMBAJTJA

| | |
|-----------------------------|---|
| Hyrje..... | 4 |
| Qëllimi i punimit..... | 5 |
| Metodologjia e punimit..... | 6 |
| Struktura e planit..... | 7 |

KAPITULLI I PARË

1. Nocioni i dënimit

| | |
|---|-----------|
| 1.1 Vështrim i përgjithshëm mbi dënimin me burg..... | 8 |
| 1.2 Elementet themelore të dënimit me burg..... | 9 |
| 1.3 Karakteristikat themelore të dënimit..... | 10 |
| 1.4 Qëllimi i dënimit..... | 13 |
| 1.5 Paraqitja e dënimeve me burgim dhe burgjet e para..... | 15 |
| 1.1.5 Faktorët që kanë ndikuar në paraqitjen e dënimit me burg..... | 16 |
| 1.2.5 Format e dënimeve me burg dhe transformimi i tyre..... | 16 |
| 1.6 Sistemet kryesore të ekzekutimit me burgim..... | 17 |
| 1.1.6 Burgu kolektiv..... | 17 |
| 1.2.6 Sistemi i izolimit ose i qelisë..... | 18 |
| 1.3.6 Sistemi i heshtjes..... | 18 |
| 1.4.6 Sistemi progresiv..... | 18 |
| 1.5.6 sistemi progresiv anglez..... | 19 |
| 1.6.6 Sistemi progresiv irlandez..... | 20 |
| 1.7.6 Sistemi i pikëve..... | 20 |
| 1.8.6 Sistemi i Gjenevës..... | 21 |
| 1.9.6 Sistemi bashkëkohor ose modern..... | 21 |
| 1.7 Rregullat minimale standarde të OKB-së, për trajtimin e të burgosurve..... | 23 |

KAPITULLI I IDYTË

| | |
|---|-----------|
| 2.1 Dënimi me burg në RM..... | 30 |
| 2.2 Akti drejtues..... | 32 |
| 2.3 Pozita dhe organizimi i sistemit gjyqësor në R.M..... | 33 |
| 2.4 Gjykata themelore, apelit dhe supreme në R.M..... | 34 |
| 2.5 Anketë..... | 35 |
| 2.6 Dënimi me burg në Gjykatën e Kërçovës..... | 36 |

KAPITULLI I TRETË

| | |
|--|-----------|
| 3.1 Struktura e personave të dënuar | 36 |
| 3.2 moshë, gjinia..... | 38 |
| 3.3 Struktura e personave të dënuar viti 2013..... | 39 |
| 3.3.1 Struktura e personave të dënuar viti 2014..... | 40 |
| 3.3.2 Struktura e personave të dënuar viti 2015..... | 42 |
| 3.3.3 Struktura e personave të dënuar viti 2016..... | 43 |
| 3.3.4 Struktura e personave të dënuar viti 2017..... | 44 |
| 3.3.5 Struktura e personave të dënuar viti 2018..... | 45 |

KAPITULLI I KATËRT

| | |
|---|-----------|
| 3.1 Dënimi me burg në Gjykatën e Gostivarit..... | 47 |
| 3.2 Struktura e personave të dënuar viti 2013..... | 49 |
| 3.2.1 Struktura e personave të dënuar viti 2014..... | 51 |
| 3.2.2 Struktura e personave të dënuar viti 2015..... | 52 |
| 3.2.3 Struktura e personave të dënuar viti 2016..... | 54 |
| 3.2.4 Struktura e personave të dënuar viti 2017..... | 55 |
| 3.2.5 Struktura e personave të dënuar viti 2018..... | 55 |

| | |
|------------------------|-----------|
| PËRFUNDIMI..... | 58 |
|------------------------|-----------|

| | |
|--------------------------|-----------|
| BIBLIOGRAFIA..... | 60 |
|--------------------------|-----------|

H Y R J E

Tema shqiptimi i dënimit me burg-apekte krahasimore midis gjykatës së Kërçovës dhe Gostivarit, është temë e cila në vete elaboron një mori çështjesh. Si fillim jepet një pasqyrë e saktë lidhur me dënimin, nocionin elementet, karakteristikat dhe qëllimin e tij. Pastaj është shtjelluar paraqitja e dënimeve me burg si dhe burgjet e para dhe transformimi i tyre. Më pas janë analizuar në mënyrë të thuktë sistemet kryesore të ekzekutimit me burgim si: sistemi i heshtjes, progresiv, sistemi i pikëve, sistemi i Gjenevës ,bashkëkohor etj. Më pas kam shkëputur disa rregulla nga standardet minimale të OKB-së lidhur me trajtimin e të burgosurëve. Në kapitullin vijues, kam përshkruar shqiptimin e dënimit me burg në RM, pozitën dhe organizimin e sistemit gjyqësor në RM, si dhe dënimin me burg në gjykatën e Kërçovës. Në kapitullin e tretë dhe të katërt kam paraqitur tabela lidhur me strukturën e personave të dënuar në gjykatën e Kërçovës dhe të Gostivarit.

E gjitha kjo është kryer për shuarjen e kureshtjes lidhur me funksionimin e gjykatave, sa janë efektive, sa është efikas dënimi me burg, sa janë të kënaqur qytetarët me vendimet e gjyqësorit, a jua besojnë problemet e tyre shtetit , a mund të durohet që kriminelët ta kthejnë shoqërinë në një kaos pa norma, besime vlera dhe ndalesa sociale, pse e humbasin ata besimin tek rregulli dhe ligjet humane të organizimit të jetës sociale, a është e lejueshme dhe e pranueshme që të ndodhin këto lloj krimesh duke iu marrë parasysh anën morale edhe atë etike.

Gjykatat tona sigurisht që nuk rrin dot duarkryq përball kesaj dukurie, edhe pse ekzistojn steriotipe dhe paragjykime te opinionit publik se puna e gjykatave nuk është e mirefilltë në RM. Por sa ia arrijnë qëllimit kjo mbetet një enigmë, e cila do të zërthehet në vijim.

Qëllimi i punimit

Një ndër qëllimet kryesore të këtij punimi është të nxirren konkludime të sakta në lidhje me të dënuarit në gjykatën e Kërçovës, dhe Gostivarit lidhur me strukturën e të dënuarve (moshën, gjinin, vendbanimin llojin e veprës së kryer dënimit e shqiptuar etj) Çështje që paraqet dilemë është efikasiteti i gjykatave. Qarkullojnë mendime publike qoftë në media apo nga qytetarët se puna e gjykatave është tejte e dobët e korruptuar dhe dënimet nuk janë reale dhe adekuate. Por sa është real ky fakt. Kjo dilemë e kahmoçme më ka drejtuar, mua personalisht rreth hulumtimit se a janë të vërteta këto spekulime apo jo dhe si realisht funksionojn gjykatat në RM duke marrë për bazë gjykatën themelore të Kërçovës dhe të apelit në Gostivar.

Qëllim tjetër i këtij punimi është edhe studimi i efikasitetit të burgjeve në vendin tonë. Të gjithë ne jemi dëshmitarë të kohës se të dënuarit gjithandej nëpër burgjet e Republikës së Maqedonisë, dënimit nuk e përjetojnë si fazë riedukimi, risocializimi dhe riaftësimi për një jetë normale por ndodh krejt e kundërta te burgosurit e përjetojnë thjeshtë si një fazë izolimi, ky është të paktën perceptimi që ekziston, dhe për mendimin tim kjo është një nga arsyet kryesore se pse të njëjtit përfundojnë duke u shëndërruar në recidivist. Në fund të dënimit supozohet se personi që lihet në liri është tashmë i padëmshëm për shoqërinë dhe rrethin në të cilin jeton, por praktika na tregon se në realitet ndodh e kundërta, dhe një fenomen i tillë kërkon një studim serioz.

Metodologjia e Punimit

Metodologjia e përdorur për përgatitjen e këtij punimi bazohet në një studim të kujdesshëm dhe hulumtim të thellë.

Hulumtimi i kësaj teme është i mbështetur nga të dhëna dhe burime të ndryshme. Duhet të potencohet se udhëzimet dhe këshillat e mentorit kanë rol të rëndësishëm në përpilimin e këtij punimi. Materialet dhe literatura e përdorur për punimin e kësaj teme të diplomës kanë për qëllim të nxjerrin në pah efikasitetin e dënimit me burg.

Metodat kryesore që janë përdorur për mbledhjen e të dhënave janë:

1. Leximi i literaturës së përshkruar më poshtë
- 2.. Anketa
3. Leximi i raporteve të punës së gjykatës së Kërçovës -Analizë e periudhës 2013-2018 ”;
4. Leximi i raporteve të gjykatës së Gostivarit-Analizë e periudhës 2013-2018 ”;
5. Të dhëna nga interneti;

Në punimin shkencor me titull: “**Shqiptimi i dënimit me burg-aspekte krahasimore në mes Gjykatës së Kërçovës dhe Gostivarit**” për të ju qasur hulumtimit kam përdorur këto metoda:

1. Metodën dogmatike juridike, (pa të cilën asnjë punim i mirëfillt shkencor nuk mund të bazohet pa këtë metodë).
2. Metodën statistikore që u referohen të dhënave të ndryshme të institucioneve sipërpërmendura.
3. Metodën empirike
4. Metodën analitike dhe induktive.

Struktura e planit

Ky punim shkencor i masterit përmban pjesën hyrëse, katër kapituj, përfundimin, rekomandimin dhe bibliografin.

Në kapitullin e parë kam dhënë një vështrim të përgjithshëm mbi dënimin, gjegjësisht nocionin e dënimit,

elementet e dënimit, qëllimi, karakteristikat. Por jo vetëm kaq, në këtë kapitull kam elaboruar edhe historikun dhe kronologjinë e sistemeve të dënimit me burg, ku janë shpjeguar të gjitha në mënyrë më gjenerale. Vlen të theksohet se kapitullin e parë e kam përmyll me rregullat minimale të OKB-së lidhur me trajtimin e të burgosuve.

Kreu pasues starton me lokalizimin e dënimit me burg në zona të caktuara. Në këtë kapitull është studiuar Gjykata e Kërçovës dhe nga ana tjetër gjykata e Gostivarit, janë elaboruar në mënyrë të saktë kompetencat e tyre, qëllimi funksionet si funksionojnë këto gjykata e kështu me rradhë. Dhe, në fund padyshim që përpos ngjajshmërive kam paraqitur edhe vijën dalluese për këto dy gjykata.

Kreu tjetër flet për strukturën e personave të dënuar, gjegjësisht moshën gjininë, vendbanimin, recidivizmin, etnitetin, veprën e kryer, dhe dënimin e shqiptuar, ku të gjitha këto i kam elaboruara në mënyrë tabelare me ndihmën e të dhënave të marra nga gjykatat e lartpërmendura.

Kapitulli i fundit lidhet me analizimin e statistikave të cilat i kam paraqitur në tabela, si për njëjërën gjykatë ashtu edhe për tjetrën. Ndërkaq si rezyme e këtij kapitulli paraqiten të dhënat mbi ndihmën postpenale të personave të dënuar, si dhe progresi që kanë arritur ato lidhur me përfundimin e dënimit.

Në përfundim jepet një pasqyrë e saktë mbi dënim me burg, funksionimin e gjykatave në vendin tonë, dënimin në përgjithsi, personat e dënuar dhe trajtimi i tyre si dhe ndihma që u jepet atyre.

KAPITULLI I PARË

1.Nocioni i dënimit

1.1Vështrim i përgjithshëm mbi dënimin

Dënimi është e keqe e paramenduar dhe e qëllimshme që i shkaktohet kryerësit për veprën e kryer në kornizat e fajit për veprën e kryer.Ky definicion përfshin edhe disa elemente.*Së pari*,dënimi është sanksion,pasojë juridike e veprës së kryer penale që e shqipton gjyqi në procedurë të paraparë me ligj.Ai është gjithmonë i përshkruar me ligj dhe ka karakter juridik-publik,me çka dallohet nga format private të reaksionit.*E dyta*,dënimi është e keqe që i shkaktohet kryerësit dhe që përbëhet në marrjen ose kufizimin e disa lirive dhe të drejtave:Liria personale(burgu),e drejta e pronësisë(dënimi me të holla)etj.*E treta*,dënimi është e keqe e qëllimshme,ajo nuk është hakmarrje ndaj hakmarrjes,represion ndaj represionit por retributivitet i llogaritur në realizimin e qëllimeve sociale të dobishme.Dhe *e katërta*,baza për shqiptimin e dënimit është kryerja e veprës dhe fajësia në atë vepër që është edhe kufiri i dënimit.Mund të dënohet vetëm kryerësi që është shpallur fajtor në kufijtë e fajësisë për veprën konkrete.Nga të gjitha elementet e nocionit të dënimit,më kontestues është padyshim ai i përcaktimit të dënimit si e keqe e *paramenduar dhe e qëllimshme*.¹

Dënimi ka dy dimensione:juridike-shtetërore dhe individuale.E para,e shpreh të drejtën shtetërore të dënimit(ius puniendi),kurse e dyta që kryerësi i veprës penale të lëndohet,të vuaj dënimin.Nënkuptohet së në këtë raport,rol dominant ka shteti që i zgjedh qëllimet,përmbajtjet dhe metodat e dënimeve duke i vendosur në korniza juridike-institucionale.²

Në shkencën e së drejtës penale njihet nocioni formal dhe material i dënimit.

Nocioni formal-përcaktohet duke pasur parasysh elementet juridike të dënimit siç janë përcaktueshmëria e tij në ligj,ligjshmëria me rastin e shqiptimit,organi i cili është kompetent për shqiptimin e tij,procedura gjyqësore që duhet të respektohet etj.³

Nocioni material- i dënimit përcaktohet duke pasur parasysh qëllimin e tij.Sipas këtij kuptimi,qëllimi kryesor i dënimit është mbrojtja e shoqërisë nga kriminaliteti dhe prevntiva me qëllim që kryerësi në të ardhmen të mos kryej vepra penale dhe përmisimi i tij,si dhe ruajtja e disiplinës së caktuar të qytetarëve në shoqëri.Nocioni formal dhe material i dënimit janë më tepër elaborime teorike,të cilat i analizojnë ndaras elementet e dënimit.Si të tilla në qoftë se vështrohen ndaras këto nocione,nuk ofrojnë kuptimin e tërësishëm të dënimit.Për këtë arsye këto dy teori në shkencë konsiderohen të njëanëshme.⁴

¹ Vllado Kambovski,Ismael Zejneli,E drejta penale pjesa e përgjithshme,Tetovë 2018,faqe250

² Vllado Kambovski,E drejta penale pjesa e përgjithshme,Shkup 2006,faqe 858,SHB" Furkan ISM"-Shkup

³ Ismet Salihu, E drejta penale pjesa e përgjithshme,Prishtinë,tetor 2012,faqe 421

⁴ Po aty.

Prandaj në shkencën bashkëkohore të së drejtës penale mbisundon mendimi se dënimi duhet të përkufizohet duke pasur parasysh si elementet formale,ashtu edhe elementet materiale të tij.Kësisoj tani në të drejtën penale konsiderohet më adekuat nocioni formalo-material i dënimit,ngase dënimi është masë penalo juridike i përcaktuar me ligj,por i cili shqiptohet me qëllim të luftimit dhe pengimit të kriminalitetit.⁵

*Sipas nocionit formalo-material,dënimi përkufizohet si masë e dhunshme e paraparë me ligj,të cilin e shqipton gjyqi ndaj kryerësit penalisht të përgjegjshëm të veprës penale,me qëllim të mbrojtjes së vlerave të caktuara të qytetarëve dhe të shoqërisë në tërësi dhe i cili konsiston në marrjen apo kufizimin e lirive dhe të drejtave të kryerësit të veprës penale.*⁶

1.2Elementet themelore të dënimit

Nga nocioni formalo-material i dënimit del se dënimi posedon këto elemente themelore:

a)sipas brendisë së tij,dënimi duhet të paraqesë vlerësim nergativ moralo-etik ndaj veprës penale dhe kryerësit.⁷

b)Si masë e dhunshme,dënimi duhet të paraqesë një të keqe,e cila e godet personin që ka kryer vepër penale.Kjo e keqe konsiston në marrjen apo kufizimin e të mirave të caktuara juridike siç janë:liria,pasuria,ndalimi i ushtrimit të profesionit,veprimtarisë,detyrës etj.Ndërsa në ato vende ku akoma parashihet dënimi me vdekje,me këtë dënim kryerësit të veprës penale i merret edhe jeta.Ky është element retributiv i dënimit.Në krahasim me sanksionet tjera penale,retribucioni te dënimi është në formën më të theksuar.⁸

c)Dënimi duhet të ketë qëllimin e caktuar,i cili dëshirohet të arrihet me ekzekutimin e tij.Qëllimi i përgjithshëm i dënimit është mbrojtja e shoqërisë dhe e qytetarëve prej veprave të rrezikshme me të cilat dëmtohen apo rrezikohen vlerat më të rëndësishme të individit dhe shoqërisë.⁹

d)Dënimi duhet të jetë i përcaktuar me ligj.Ky është parim i ligjshmërisë së dënimit sublimuar në maksimumin e njohur latine **nulla poena sine lege**(nuk mund të shqiptohet dënimi nëse nuk është i paraparë me ligj)Sipas këtij parimi ,kryerësit mund ti shqiptohet vetëm ai lloj dhe ajo lartësi e dënimit që është e paraparë me ligj për veprën penale konkrete.Parimi i ligjshmërsi paraqet garanci dhe mbrojtje të qytetarëve nga arbitrariteti eventual i organeve shtetërore.Përkatësisht,cënimi i parimit të ligjshmërisë së dënimit nga ana e organeve shtetërore

⁵ Ismet Salihu, E drejta penale pjesa e përgjithshme,Prishtinë,tetor 2012,faqe 421

⁶ Po aty ,faqe 422

⁷ Po aty.

⁸ Po aty.

⁹ Po aty.

paraqet një rëndësi nga shkeljet më të rënda të ligjit dhe ndaj qytetarëve shkakton pasoja shumë të rënda, të cilat zakonisht janë të papërmisushme.¹⁰

e) Dënimi mund të shqiptohet vetëm ndaj kryerësve të veprave penale që janë penalisht të përgjegjshëm. Përkatesisht, dënimi mund të shqiptohet vetëm atyre personave të cilët në kohën e kryerjes së veprës penale kanë qenë të përgjegjshëm dhe të fajshëm. Kjo nga fakti se vetëm personi penalisht i përgjegjshëm mund të përjetojë dënimin si një e keqe e cila e godet për shkak të veprës së dëmshme që e ka kryer dhe vetëm ndaj personit të këtillë dënimi mund të ketë efekt që ai në të ardhmen të mos kryej vepra penale.¹¹

f) Dënimi mund ta shqiptojë vetëm gjykata sipas procedurës së përcaktuar me ligj. Kjo procedurë duhet të garantojë rregullsinë e shqiptimit të dënimit. Asnjë organ tjetër nuk mund të shqiptojë dënim kryerësit të veprës penale.¹²

Elementet e sipërpërmendura të dënimit janë të natyrës konstitutive. Në mungesën e vetëm njërit nga këto elemente nuk mund të ketë dënim në kuptimin e mirëfilltë të së drejtës penale. Nga kjo rezulton se pa përjashtim, çdo dënim duhet medoemos të posedojë të gjitha elementet e përcaktuara.¹³

Sipas mendimit tim, për sa u përket elementeve të dënimit, lidhur me pikën f, ku thuhet se: Dënimi mund ta shqiptojë vetëm gjykata sipas procedurës së përcaktuar me ligj. Kjo procedurë duhet të garantojë rregullsinë e shqiptimit të dënimit. Asnjë organ tjetër nuk mund të shqiptojë dënim kryerësit të veprës penale. Më personalisht nuk më duket tërësisht e drejtë për faktin se në gjyqësorin tonë, impakti i gjërë ka politika, që domethënë se vendimet nuk mvarren drejtëpërdrejtë nga gjykata por edhe nga pushteti.

1.3 Karakteristikat themelore të dënimit

Duke u nisur nga elementet konstitutive si dhe funksionimin që duhet ta ushtrojë dënimi, e drejta penale bashkëkohore i përcakton edhe disa karakteristika, apo tipare që duhet të përmbushen me rastin e shqiptimit dhe zbatimit të tij. Këto tipare themelore të dënimit konsistojnë në sa vijon:¹⁴

a) **Dënimi duhet të jetë personal.** Ndryshe nga të drejtat penale primitive, sipas të cilave dënimi e ka goditur jo vetëm kryerësin e veprës penale por edhe të afërmit e tij, anëtarët e familjes, anëtarët e familjes apo të fisit të tij, sipas të drejtave penale bashkëkohore, dënimi duhet të jetë personal. Kjo do të thotë që dënimi duhet të godas kryerësin e veprës penale, e jo edhe personat e tjerë. Mirëpo, duhet theksuar se përkundër këtij parimi dhe synimeve politike ndëshkuese bashkëkohore që të përmbushet ky kusht, që dënimi duhet të jetë personal, ta godasë vetëm

¹⁰ Po aty, faqe 423

¹¹ Po aty

¹² Po aty

¹³ Po aty

¹⁴ Ismet Salihu, E drejta penale pjesa e përgjithshme, Prishtinë, tetor 2012, faqe 423

kryerësin e veprës penale, edhe tani pothuaj çdo dënim në një formë dhe masë godet edhe personat e tjerë, sidomos anëtarët e familjes dhe të afërmit e tjerë të fajtorit. Për shembull, pasojat negative të dënimit janë të pashmangshme në rastin kur i ati i fëmijëve kryen vepër penale dhe dënohet. Pasojat negative, ato materiale, psikologjike e të tjera, gjithsesi në një formë dhe masë i godasin fëmijët, bashkërtotën, madje edhe të afërmit e tjerë.¹⁵

b) Dënimi duhet të jetë human-kjo do të thotë se dënimi nuk guxon të paraqet mundim dhe përbuzje të delikuentit, si dhe nuk guxontë shkaktojë dëmtimin e shëndetit të tij. Në këtë drejtim konventat ndërkombëtare, Kodi i Procedurës penale dhe ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale garantojnë respektimin e personalitetit dhe dinjitetin e njeriut në procedurën penale dhe gjatë fazës së ekzekutimit të dënimit. Gjithashtu, edhe disa konventa ndërkombëtare, që u referohen lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit, siç janë Deklarata universale mbi të drejtat e njeriut dhe Pakti ndërkombëtar mbi të drejtat civile dhe politike, parashohin edhe norma me të cilat kërkohet që dënimi të jetë human.¹⁶

c) Dënimi duhet të jetë legjitim-Rrjedhimisht për të qenë dënimi human, ai duhet të jetë edhe legjitim. Dënimi është legjitim vetëm nëse gjyqi shqipton asnjë lloji dhe lartësie të dënimit, i cili është i domosdoshëm për mbrojtjen e shoqërisë nga kriminaliteti dhe për përmisimin e fajtorit. Lidhur me këtë është mjaft impresiv konstatimi vijues: "Një represion, që nuk është i preokupuar me resocializimin e delikuentit, bën një punë të kotë dhe humane". Përkatësisht, nëse shqiptohen dënime drakonike, të cilat në masë të theksuar kanë primesa retributive dhe shprehin hakmarrje, madje dhe urrejtje ndaj delikuentit, atëherë ato dënime nuk janë legjitime dhe në brendinë e tyre janë edhe kundërligjore.¹⁷

d) Brenda suazave ligjore që lejojnë individualizimin e dënimit, dënimi duhet të godasë njësoj kryerësit e veprave penale, pa marrë parasysh përkatsin nacionale, fetare, racore, politike, sociale etj. Kjo tipare e dënimit në fakt konsiston në realizimin e politikës ndëshkuese unike. Kjo çështje është posaçërisht e rëndësishme në të drejtat penale bashkëkohore, sepse në legjislacionet penale në fuqi sanksionet penale, në kuadrin e tyre edhe dënimet, janë ashtu të parapara sa që gjyqeve u japin autorizime të mëdha lidhur me zgjedhjen e llojit dhe masës së dënimit që mund të shqiptohet kryerësit të veprës penale. Kjo tipare implikon në vete kërkesën që kryerësit e veprave penale identike të dënohen me dënime identike. Në të kundërtën, nëse vijnë e shprehen zgjidhje kontradiktore në fushën e politikës ndëshkuese ndër aktgjykime të të njëjtit gjyq apo të gjyqeve të viseve të ndryshme të shtetit, për të njëjtat vepra të kryera nga kryerës të ngjajshëm, atëherë ky është shembull tipik i pabarazisë së qytetarëve.¹⁸

¹⁵ Po aty.

¹⁶ Po aty, faqe 424

¹⁷ Po aty.

¹⁸ Po aty.

e) Dënimi duhet të jetë proporcional me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjesisë penale të kryerësit. Me këtë tipar përmbushet edhe postulati i drejtësisë së dënimit. Përpjestueshmëria dhe drejtësia e dënimit shprehet duke pasur parasysh jo vetëm peshën e veprës penale, por edhe rrethanat e tjera objektive dhe subjektive, siç janë p.sh: jeta e mëparshme e kryerësit, sjellja pas kryerjes së veprës penale, qëllimet speciale dhe gjenerale të dënimit etj.¹⁹

f) Dënimi duhet të jetë i ndarë. Dënimi është i ndarë në qoftë se ai mund të shqiptohet në masë më të vogël apo më të madhe, varësisht nga pesha e veprës penale, rrethanat në të cilat ajo është kryer dhe rrezikshmërisë së kryerësit të veprës. Ky tipar shprehet te dënimi me heqje të lirisë dhe te dënimi me të holla, por jo edhe te dënimi me vdekje.²⁰

g) Dënimi duhet të jetë i revokueshëm. Përkatësisht, në rastet kur konstatohet se dënimi është shqiptuar në kundërshtim me ligjin, për shkak të lajthimit të gjyqit apo provave të rrejshme, ai duhet të abrogohet. Edhe ky tipar nuk mund të shprehet te dënimi me vdekje, nëse është bërë ekzekutimi i tij.²¹

h) Dënimi duhet të jetë i përmisushëm. Edhe ky tipar duhet të shprehet në rastet kur dënimi është shqiptuar në kundërshtim me ligjin për shkak të dëshmisë së rrejshme apo ndonjë rrethane tjetër. Dënimet pasurore janë të përmisueshme, mirëpo dënimi me vdekje nëse është ekzekutuar, nuk mund të përmisohet. Gjithashtu për shkak të pasojave të shumta të natyrës së ndryshme, sipas shumicës së shkenctarëve të së drejtës penale, edhe dënimi me burg, i cili pjesërisht apo në tërësi është ekzekutuar, nuk mund të përmisohet, ngase të dënuarit nuk mund ti kthehet liria gjatë asaj kohe që ka qëndruar në burg. Kompensimi në të holl që jepet në këto raste, më tepër ka karakter të dëmshpërblimit material, dëmshpërblim ky i cili nuk mund ti eliminojë të gjitha pasojat e shkaktuara të dënimit me burg.²²

Sipas mendimit tim lidhur me karakteristikat e dënimit, bazuar në pikën d, unë personalisht nuk jam plotsisht e bindur se në vendin tonë dënimi është i njëjtë për të gjithë. Them kështu sepse të gjithë ne jemi dëshmitarë të kohës se si udhëheqësit politik ende janë të lirë, ndërkaq shtresa tjetër popullsisë merr dënime të pamërituara. D.m.th, mendoj se dënimi nuk godet njëjtë të gjithë, qoftë duke u bazuar në aspekt fetar, racor, e me theks të veçantë etnik e politik. Gjithashtu lidhur me pikën b ku thuhet se dënimi duhet të jetë human, edhe këtu krijohet disi hamendje për arsye se ,vetë të dënuarit ankohen vazhdimisht qoftë në media apo forma tjera se dënimi i shqiptuar ka shkaktuar përbuzje, nënçmim, si dhe traum ndaj tyre. Prandaj mendoj se duhet të kenë kujdes gjykatësit në këtë drejtim.

¹⁹ Po aty.

²⁰ Po aty, faqe 425

²¹ Po aty.

²² Po aty.

1.4 Qëllimi i dënimit

Që nga paraqitja e së drejtës penale e deri më sot, çështja e qëllimit të dënimit, sikundër edhe çështja e bazës juridike të dënimit, është në qendër të vëmendjes së shkenctarve. Kjo çështje është studiuar në aspektin juridik dhe filozofik. Rrjedhimisht, me rastin e parashikimit të dënimit me ligj, është shtruar pyetja se çka dëshirohet dhe çka arrihet me zbatimin e dënimit. Në shqyrtimin e kësaj çështjeje janë shfaqur mendime dhe teori, duke i marrë parasysh tiparet e tyre të përbashkëta, mund të rradhiten në tre grupe themelore: teoritë absolute, teoritë relative dhe teoritë e përziera ose ekletike.²³

Teoritë absolute – sipas këtyre teorive qëllimi i dënimit është hakmarrja ndaj personit që kryen veprë penale. Me kryerjen e veprës penale, individit i shkakton një të keqe shoqërisë, për këtë shkak shoqëria ia kthen këtë të keqe me zbatimin e dënimit. Sipas ithtarëve të këtyre teorive, vepra penale është rezultat i vullnetit të lirë të njeriut, andaj edhe hakmarrja paraqitet si i vetmi qëllim i dënimit. Së këndejmi, dënimi është qëllim në vete, është i domosdoshëm dhe për këtë shkak është absolut. Me fjalë të tjera, sipas ithtarëve të kësaj teorie dënimi nuk është asgjë tjetër përveç se hakmarrje, shpëtim i mëkateve për shkak të veprës penale të kryer. Përkatsisht, sipas autorëve të së drejtës hyjnore, hakmarrja paraqitet si detyrim i perëndisë, ndërsa sipas përfaqësuesve të drejtsisë morale, dënimi është domosdo e kategorisë imperative (Kanti), kurse sipas autorëve të drejtsisë ligjore (Hegeli), dënimi është domosdo dialektike. **Si e metë** kryesore e teorive absolute është se këto në tërësi injorojnë qëllimet sociale të dënimit. Përkatsisht, këto teori nuk marrin fare parasysh rolin dhe detyrat e shtetit dhe të shoqërisë për të mbrojtur nga kriminaliteti vlerat vitale të qytetarëve dhe kombit në përgjithsi. Është domosdo e pamohueshme se dënimi duhet të jetë edhe ultalitar (i dobishëm), duhet të realizojë edhe qëllimin e preventivës individuale dhe gjenerale, e jo vetëm qëllim në vete, vetëm të hakmerret duke i shkaktuar të keqe kryerësit të veprës penale.²⁴

Teoritë relative – Përfaqësuesit e këtyre teorive janë të mendimit se dënimi duhet të ketë qëllim të caktuar social dhe se hakmarrja dhe shpëtimja e mëkateve për veprën penale të kryer, për të keqen e shkaktuar, nuk duhet të i vetmi qëllim i dënimit. Me fjalë të tjera, sipas përfaqësuesve të këtyre teorive, dënimi nuk duhet të jetë qëllim në vete, por mjet për mbrojtjen e shoqërisë nga kriminaliteti. Platformë kryesore e teorive relative është preventiva e kriminalitetit. Efekti represiv i dënimit duhet të jetë rezultat sekondar e jo qëllimi kryesor. Sipas këtyre teorive, qëllimi kryesor i dënimit pra është preventiva, që kryerësi i veprës penale në të ardhmen të mos kryej vepra penale të këtilla. Dënimi nuk është domosdo absolut por relativ. Teoritë relative ndahen në dy grupe themelore.²⁵

²³ Ismet Salihu, E drejta penale pjesa e përgjithshme, Prishtinë, tetor 2012, faqe 428

²⁴ Po aty, faqe 429

²⁵ Po aty.

a)Teoria e preventivës speciale qëllimi i dënimit është që kryerësin e veprës penale ta pengojë që në të ardhmen sërish të kryejë veprë penale. Disa përfaqësues të kësaj teorie janë të mendimit se ky qëllim mund të arrihet duke e friksuar kryerësin gjatë ekzekutimit të dënimit, në mënyrë që ai në të ardhmen të mos kryej veprë penale. Teoria e preventivës speciale, nënkupton gatishmërinë e shoqërisë që pasi kryerësi i veprës ta vuaj dënimin, ta konsiderojnë atë si anëtar të barabartë të shoqërisë.²⁶

b)Sipas teorisë së preventivës gjenerale qëllimi i dënimit është që të ushtrojë efekt friksues ndaj kryerësve të mundshëm të veprave penale dhe në këtë mënyrë ti zbrapsë nga kriminaliteti. Dënimi i paraprë në ligj, sipas përfaqësuesve të kësaj teorie ia bën me dije çdo qytetari se do ta godas e keqja (dënimi) nëse kryen veprë penale. Në një mënyrë, sipas teorisë së preventivës së përgjithshme, dënimi duhet të ushtrojë efektin e higjienës sociale.²⁷

Teoritë e përziera. Këto teori janë paraqitur duke i përvetsuar elementet pozitive të teorisë absolute dhe relative. Pra janë sintezë e teorisë absolute dhe teorisë së preventivës individuale dhe gjenerale. Sipas përfaqësuesve të kësaj teorie, qëllimi i dënimit nuk mund të arrihet vetëm me represion (vetëm me hakmarrje), por jo edhe vetëm me preventivë. Por duhet të gërshetohen të dy elementet.²⁸

Duke marrë parasysh teoritë lidhur me qëllimin e dënimit, unë më shumë anoj nga teoria relative, sepse qëllimi i dënimit nuk duhet të jetë hakmarrja siç theksohet tek teoritë absolute, sepse sipas meje s'arrihet gjë me revansh. Ndërsa risocializimi, riedukimi janë në benefit të të dënuarit dhe të gjithë shoqërisë në përgjithsi.

Qëllimi i dënimit në KPM

Qëllimi i përgjithshëm i sanksioneve penalo-juridik-mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe vlerat tjera themelore nga veprat penale.²⁹ KPM e konkretizon duke përcaktuar edhe qëllime të veçanta të sanksioneve të ndara, kështu që neni 32 thotë:

neni 32

Përpos realizimit të drejtësisë, qëllimi i ndëshkimit është³⁰

1) pengimi i kryerësit të kryej vepra penale dhe riedukimi i tij, dhe

2) në mënyrë edukative të ndikojë ndaj tjerëve të mos kryejnë vepra penale

²⁶ Po aty, faqe 430

²⁷ Po aty.

²⁸ Po aty, faqe 431

²⁹ Vllado Kambovski, E drejta penale pjesa e përgjithshme, Shkup 2006, faqe 888, SHB "Furkan ISM"-Shkup

³⁰ Afrim Osmani, Kodi Penal i RM-së, Shkup 2010, faqe 55, SHB Furkan ISM 2010

Unë personalisht ,në mënyrë absolute pajtohem me nenin 32,sepse realisht qëllimi i dënimit duhet të jetë riedukimi,pengimi i kryerësit për vepra penale,si dhe preventiva gjenerale.Ndërkaq sipas prof.dr Vllado Kambovski, si qëllime të posaçme të dënimit përveç realizimit të drejtësisë të ndara janë:ndalimi i autorit të kryej vepra penale dhe riedukimi i tij,dhe ndikimi edukativ mbi të tjerët për të mos kryer vepra penale.Me këtë,ligji thekson në fakt funksionet polivalente të dënimit:retribucionin dhe preventivën speciale dhe gjenrale.

Si instrumente kryesore për realizimin e qëllimeve të dënimit janë:matja gjyqësore e dënimit e bazuar mbi parimet e individualizimit të dënimit,vuajtja e dënimit dhe regjimi i pozitës juridike të të dënuarit pas vuajtjes së dënimit.Koncepti ligjor i qëllimeve të dënimit rumbullaksohet nëpërmjet unitetit të mbrendshëm të qëllimeve i të gjitha fazave të funksionimit të sistemit të drejtësisë penale pa kundërshtime të brendhme që do të kishin për pasojë neutralizimin e efekteve të fazës së mëhershme.³¹

1.5Paraqitja e dënimeve me burgim dhe burgjet e para

Dënimet me burgim janë sanksione penale të cilat në shtetet bashkëkohore,aplikohen më së shumti në praktikën gjyqësore.Dënimet me burgim kanë pasur një histori gjatë zhvillimit dhe transformimit.Ato kanë kaluar një rrugë interesante evolutive.Paraqitja e dënimeve me burgim,fillon që nga koha e burgjeve të para e deri te dënimet bashkëkohore me burgim. Burimet historike flasin se e drejta e shteteve të lashta si e drejta kineze,e drejta asirase e drejta egjiptase dhe të drejtat tjera e kanë njohur burgun.Në Greqinë dhe Romën e vjetër dhe në disa shtete mesjetare,gjithashtu kanë ekzistuar burgje.Kësisoj këto burgje kanë qenë të vendosura në kështjella të vjetra ``*Bastilles*`` ose në bodrumet e kalave ``*Qublietes*`` të cilat kanë qenë të braktisura,ndërsa kushtet e qëndrimit kanë qenë shumë të rënda dhe të vështira.Në Romën e vjetër ka qenë i njohur burgu ``*Tullanium*``ku mbaheshin personat e dyshimtë derisa u shqiptohej dënimi kryesor.Qëllimi i këtij burgimi apo paraburgimi,ka qenë sigurimi i kryerësit derisa të mbahej gjykimi dhe pengimi i ikjes së tij para se ti shqiptohej dhe ekzekutohej dënimi.Zakonisht dënimet më të shpeshta që u shqiptoheshin personave të tillë që gjendeshin nëpër burgje ishin dënimet trupore dhe me vdekje,e në disa raste edhe dënimet me gjobë. Në mesjetë gjithashtu mund të thuhet se nuk ka ekzistuar ndonjë dënim me burg në kuptimin e plotë të fjalës.Edhe në këtë kohë burgu ka pasur më shumë karakter të një mase preventive.Disa autorë theksojnë se ka ekzistuar një lloj ndëshkimi i jashtëzakonshëm me burgim për disa kategori të delikuentëve si p.sh për kategorine e heretikeve në formë të *Morus Lorgus* ose në formë të *Morus strictus* ku personat e dënuar qëndronjin një kohë të gjatë në qeli dhe kështjellat e kalat ishin të izoluar brenda mureve dhe delikuentët qëndronin vetëm me bukë dhe ujë.³²

³¹ Vllado Kambovski,E drejta penale pjesa e përgjithshme,Shkup 2006,faqe 890,SHB''Furkan ISM''-Shkup

³² Ragip Halili,Penologjia,Prishtinë 2011,faqe 93

1.1.5 Faktorët që kanë ndikuar në paraqitjen e dënimit me burgim

Sistemi i ndëshkimit, gjatë kohës së vjetër dhe gjatë mesjetës, në pjesën më të madhe bazohej në dënimet trupore e fizike dhe në dënimet me të holla ose me gjobë. Këto dënime ishin në përputhje me pikëpamjet dhe botëkuptimet dominuese mbi hkmarrjen dhe shpagimin si qëllim kryesor të ndëshkimit. Mirëpo kjo mënyrë e luftimit të kriminalitetit nuk ishte aq efektive. Dënimet trupore, me vdekje, deportimet dhe dënimet tjera iu nënshtruan kritikave të ashpra. Ato u cilësuan si mjete dhe metoda barbare.³³

Kështu që masa e burgimit që përdorej në kohën e vjetër dhe në mesjetë si masë preventive si paraburg ose si burg për endacakë nuk dha rezultate të pritura për pengimin e kriminalitetit. Ideja e kyçjes së personit të dënuar në punë dhe aktivitete dalëngadalë depërtoi në legjislacionin penal të Evropës.³⁴

Si faktorë që ndikuan në paraqitjen e dënimit me burg janë:

1. Mendimet dhe idetë humaniste e përparimtare të filozofëve dhe shkollave të ndryshme
2. Idetë dhe kontributi i Revolucionit francez dhe legjislacioni i tij penal si dhe ndikimi i pranisë së lirive dhe të drejtave themelore të qytetarëve si dhe
3. Shfrytëzimi i punës së personave të dënuar si fuqi e lirë punëtore³⁵

1.2.5 Format e dënimeve me burgim dhe transformimi i tyre

Dënimi me burgim si sanksion penal, sipas konstatimeve në literaturë, për herë të parë është paraparë në Kodin Penal francez të vitit 1792. Mirëpo, këto dënime, shikuar për kah llojet dhe mënyra e ekzekutimit kanë ndryshuar, prej momentit të paraqitjes e deri në ditët e sotme. Rruga e transformimeve dhe ndryshimeve të dënimeve me burgim mund të përcillet në dy faza kryesore.³⁶

Faza apo periudha e parë përfshin kohën që nga paraqitja e këtyre dënimeve e deri te gjysma e parë e shekullit XX. Kjo fazë karakterizohet me afirmimin e dënimeve me heqjen e lirisë si dënime më të favorshme dhe më humane për kryerësin. Në këtë periudhë, dënimet me burgim bëhen dënime dominuese, ku dallohen disa dënime me burgim:

Burgimi, internimi, burgu i rëndë, burgu shtëpiak, burgu i përjetshëm, burgu me pranga, burgu i lehtë etj. Karakteristikë për këtë fazë të dënimeve me burgim është fakti se kanë ekzistuar një

³³ Ragip Halili, Penologjia, Prishtinë 2011, faqe 96

³⁴ Po aty, faqe 96

³⁵ Po aty.

³⁶ Po aty, faqe 98

numër i madh i formave të dënimeve me burgim. Gjithashtu, edhe mënyra e ekzekutimit të këtyre dënimeve ka qenë e llojllojshme dhe zakonisht në fillim ka qenë e mbështetur në iden dhe qëllimin e hakmarrjes dhe shpagimit. Burgjet në të cilat mbaheshin keto dënime, në fillim ishin disa bodrume të kështjellave dhe kalave mesjtare, fortesa dhe kazerma të braktisura ku kushtet ishin shumë të vështira. I tillë ishte edhe burgu në kalan e Gjirokastrës.³⁷

Faza apo periudha e dytë e zhvillimit dhe transformimit të dënimit me burgim, përfshin kohën e përpjekjeve të mëdha për transformimin e plotë të qëllimit dhe të karakterit të dënimit me burgim. Shumë autorë mendojnë se dënimet me burgim duhet të unifikohen dhe të reduktohen në një dënim i cili ka për qëllim vetëm riintegrimin e personave të dënuar dhe pengimin e kriminalitetit. Kështu vërehet një tendencë e përhershme që dënimet me burgim të shëndërrohen nga mjete klasik të represionit në një mjet dhe masë modern të rehabilitimit shoqëror të personit të dënuar.³⁸

Faza e tretë ose bashkëkohore përfshin sanksionet dhe masat më të reja të cilat kanë ardhë në shprehje edhe në kodet dhe ligjet penale që janë aprovuar gjatë dekadave të fundit dhe në të cilat vend të veçantë zënë masat e diversitetit ndaj të miturve, dënimet alternative, dënimet me kusht, dënime plotësuese dhe forma tjera të zëvendimit të dënimit me burgim etj.³⁹

1.6 Sistemet kryesore të ekzekutimit të dënimit me burgim

1.1.6 Sistemi i burgut kolektiv

Sipas disa autorëve ky është sistemi i parë i organizimit të ekzekutimit të dënimit me burgim. Autorë të tjerë këtë sistem nuk e trajtojnë si sistem të pavarur të ekzekutimit të dënimit me burg. Ky sistem është aplikuar që nga momenti i parë i paraqitjes së dënimeve me burgim dhe ka ekzistuar deri sa janë bërë reforma të dukshme në shekullin XIX. Si karakteristikë themelore e këtij sistemi është se gjithë personat e dënuar, dënimin e mbajnë në mënyrë të përbashkët dhe kolektive. Personat e dënuar sipas këtij sistemi, janë të izoluar vetëm nga bota e jashtme, mirëpo brenda mureve të institucioneve-burgjeve, ata jetojnë në kolektiv. Sipas këtij sistemi, nuk ka klasifikim të të dënuarve, ndodh, që sëbashku dënimin ta mbajnë të dënuarit për krime të rënda, recidivistë, persona me karrierë të gjatë kriminale, personat e vjetur me të miturit, kryerësit primar me sekondarë etj. Si lokale për ekzekutimin e dënimit me burgim, gjatë aplikimit të këtij sistemi, në fillim shërbenin: bodrumet dhe lokalet e braktisura të fortesave, kështjellave, kalave dhe objekteve të vjetra ku kushtet e jetës ishin shumë të rënda. Kushtet higjienike dhe shëndetësore në këto burgje në këto burgje e ente ishin të mjerueshme. Për këtë arsye ato ishin vatër e përhapjes së smundjeve ngjitëse.⁴⁰

³⁷ Po aty.

³⁸ Po aty, faqe 100

³⁹ Po aty, faqe 101

⁴⁰ Po aty, faqe 102

1.2.6 Sistemi i izolimit ose i qelisë

Me këtë sistem fillon zbatimi në jetë i disa ideve dhe propozimeve të reformatorëve të burgut kolektiv. Sistemi i izolimit apo qelisë është sistemi i parë që është rregulluar në mënyrë normative juridike. Këtë sistem për herë të parë e predikojnë besimtarët e një sekti protestant dhe kuekere. Pjestarët e këtij sekti ishin kundër aplikimit të dënimit me vdekje dhe torturave fizike dhe në vend të tyre propozonin izolimin, vetmimin e të dënuarve. Sipas kësaj pikëpamje personi i dënuar, ka kohë të mendojë për veprën dhe sjelljet e tij kriminale. Në këtë mënyrë atij i jepet shansi për tu penduar për veprimet kriminale dhe për tu përmisuar në pikëpamje morale. Sipas këtij sistemi të gjithë të dënuarit duhet të vendosen nëpër kthina të veçanta, nëpër qeli, dhe të qëndrojnë të vetmuar një kohë të caktuar dhe në këtë mënyrë të pendohen për krimin që kanë bërë. Në literaturën penologjike përmenden dy lloje të këtij sistemi: ai klasik dhe i heshtjes apo Oberrit. Sistemi klasik ka qëndruar më shumë në praktikën peritensiare. Personi i dënuar sipas këtij sistemi nuk ka patur kurrfarë kontakti me botën e jashtme, dhe është menduar se kriminelët do të përjetojnë njëfarë rilindje dhe ripërmisimi si dhe do të pendohen. Izolimi ka qenë tejet rigoroz. Këto persona nuk kanë patur kontakt me tjerët bile kur kanë dal për të dëgjuar meshën apo ndonjë vizitë të mjeku kanë bartur maska që të eliminohej çdo mundësi kontakti përmes shqisave të të pamurit.⁴¹

1.3.6 Sistemi i heshtjes

Në qytetin Auburn të shtetit të Nju Jorkut, u bënë përpjekje për reformimin e sistemit të qelisë. Në këtë mënyrë, në burgun e këtij qyteti, duke patur parasysh vërejtjet e mëparme ndaj sistemit të qelisë në ekzekutimin e dënimit me burg tani u bënë disa risi. U bë një lloj kombinimi midis sistemit të qelisë dhe sistemit të burgut kolektiv. Sipas këtij sistemi personat e dënuar natën qëndronin të izoluar plotësisht, ndërsa gjatë ditës, ata dërgohen në punë dhe aty u jepet mundësia të dalin nga izolimi të punojnë sëbashku me të dënuarit. Mirëpo, gjatë kohës së punës ata e kanë pasur të ndaluar çdo bisedë. Mosrespektimi i ndalesës së komunikimit dhe obligimit të heshtjes është dënuar në mënyrë rigoroze. Ndalimi i komunikimit është bërë gjoja për pengim të infektimit kriminal në mes tyre të dënuarit kanë qenë të angazhuar në punë dhe kanë mësuar ndonjë zanat ose mjeshtëri si mangësi të këtij sistemi paraqiten heshtja ndërmjet të dënuarve. Aplikimi i torturës, dhe kufizimi i disa të drejtave elementare.⁴²

1.4.6 Sistemi progresiv

Në vazhden e përpjekjeve për reformimin e sistemeve të ekzekutimit me burg, veçmas dallohen të ashtëquajturat sisteme progresive të cilat bëjnë përpjekje më të mëdha për ndryshimin e pozitës së të dënuarit gjatë mbajtjes së dënimit. Në këtë mënyrë për herë të parë shtrohet nevoja e parashikimit të disa mjeteve stimuluese dhe shpërblimin e të dënuarve për sjellje të mira dhe punë të sukseshme.

⁴¹ Po aty, faqe 105

⁴² Ragip Halili, Penologjia, Prishtinë 2011, faqe 107

Gjithashtu u parapa edhe obligimi i aftësimit dhe arsimimit të personave të dënuar gjatë qëndrimit nëpër ente. Po ashtu u kërkua përmisimi i kushteve higjienike dhe shëndetësore në lokalet ku mbahej dënimi me burgim. Këto sistemi u paraqitën fillimisht në Angli dhe në Irlandë. Karakteristika themelore e këtij sistemi qëndron në fakti se personi i dënuar kalon në disa faza. Në fillim ai vendoset në burgun e qelisë pra në sistemin e izolimit të plotë. Mbas një kohe nëse janë bërë ndryshime positive i dënuari kalon në burgun e përbashkët-kolektiv. Në burgun kolektiv ai kyçet në procesin e punës dhe në këtë mënyrë ka mundësi që me procesin e punës. Nëse këtë fazë e kalon me sukses dhe te personeli i institucionit krijohet bindje se dënimi ka pasur efekt ai kalon në fazën vijuese e cila është mjaft e favorshme. Faza vijuese mund të jetë lirimi me kusht ose qëndrimi në të ashtëquajturën paralele për të lirë.⁴³

1.5.6 Sistemi progresiv anglez

Ky sistem është zbatuar ndaj personave të cilët kanë mbajtur dënimet me burgim me kohëzgjatje më të madhe. Sipas këtij sistemi nuk është mirë që personi i dënuar të qëndrojë tërë kohën në qeli dhe nga qelia të dalë në liri, sepse gjatë vuajtjes së dënimit ai nuk është përgatitur për liri. Sipas këtij sistemi të dënuarit kalojnë nëpër tre faza edhe atë:

Faza e parë e mbajtjes së dënimit me burgim (faza e qëndrimit në qeli) Mirëpo në këtë fazë të dënuarit kanë mundur të fitojnë disa beneficione si: përmisimin e ushqimit, përmisimin e kushteve higjienike, shfrytëzimi i literaturës, mundësia e vizitave etj. Poashtu personat e dënuar ndaheshin në grupe dhe nëngrupe të caktuara.

Faza e dytë e sistemit progresiv qëndron në mbajtjen e përbashkët të dënimit me burg. Në këtë fazë personat e dënuar gjatë ditës, punojnë sëbashku me personat tjerë pa obligim të heshtjes. Mirëpo gjatë natës nuk kanë mundur të komunikojnë. Personat duke punuar janë aftësuar akoma më shumë kanë fituar zanate të reja. Në këtë fazë vërehet një lloj klasifikimi dhe ndarje e personave të dënuar në grupe dhe nëngrupe të ndryshme. Klasifikimi në këtë fazë bëhet sipas disa kritereve edhe atë: sipas moshës, motiveve, veprës së kryer, peshës së veprës, lartësisë së dënimit dhe disa kritereve tjera. Tanimë personat e dënuar fitojnë të drejta dhe privilegje lidhur me përmisimin e ushqimit, vizita, shpërblime nga jashtë.

Faza e tretë e sistemit progresiv anglez qëndron në lëshimin me kusht të të dënuarit.

Përveç benefiteve të përmendura ky sistem ka edhe anëën negative sepse thuhet se personat e dënuar i kanë kryer me pikpmëri disa obligime me qellim që të lirohen e jo se me të vërtetë janë përmisuar.⁴⁴

⁴³ Po aty, faqe 109

⁴⁴ Po aty, faqe 110.

1.6.6 Sistemi progresiv irlandez

Ky sistem është gati gati i njëjtë me atë anglez. Por ky sistem dallohet nga ai anglez sepse në vete involvon edhe një fazë dmth fazën e katërt. Faza e qelisë, Faza e burgut të përbashkët, fazën e qëndrimit në paralele për të lirë dhe fazën e lëshimit me kusht. Themeluesi i këtij sistemi është Ealter Grofton i cili propozon që personat e dënuar para se të lirohen me kusht të vendosen në një objekt të veçantë ku kushtet e jetës dhe punës janë krejtësisht tjera nga ato të personave që gjenden në fazën e burgut të përbashkët.⁴⁵

1.7.6 Sistemi i pikëve ose i Monakut

Paraqet një variantë të sistemit progresiv mirëpo duhet theksuar se ky sistem më tepër është një orvatje për aplikimin e një metode të ekzekutimit të dënimit me burgim se sa ndonjë sistem i pavarur dhe i verifikuar. Shumë autorë këtë nuk e llogarisin si sistem të veçantë po si një lloj eksperimentimi apo modeli i cili nuk u praktikua shumë. Ky sistem që rezultoi i Aleksandar Makonakut. Ai ishte kundër dhunës që ushtroheshin ndaj të dënuarve. Ai mendonte se duhet të gjenden mënyra dhe metoda me të cilën personat e dënuar do të angazhoheshin në punë dhe të shpërbleheshin për punën e kryer.⁴⁶

Në fazën e parë ata kanë qenë të detyruar të punojnë, janë kyçur në procesin e punës po puna ka qenë shumë e rëndë dhe detyrimet lidhur me rendin shtëpiak kanë qenë rigorozë. Personat e dënuar në këtë fazë nuk kanë pasur kurrfarë favorizimesh. Kohëzgjatja e qëndrimit të personave në kushte të tilla nuk ishte në mënyrë precize e caktuar ajo varej nga vlerësimi i personelit të institucionit.

Faza e dytë u mundësonte të dënuarve të ndahen në grupe pune. Këto grupe pune ishin të vogla, nga pesë gjashtë të dënuar. Për secilin grup të të dënuarve caktohej numri i poenave a i pikëve që duhet të përmbushte. Ndërsa vetë të dënuarit ia caktonin njëri tjetrit numrin e pikëve. Personat e dënuar gjatë caktimit të numrit të poenave për secilin anëtar të grupit merrnin parasysh aftësitë fizike, shëndetësore të anëtarëve të grupit dhe në këtë mënyrë krijohej njëfarë solidariteti në mes të dënuarve. Rezultatet e favorshme në punë kanë ndikuar që të përmisohet dukshëm edhe gjendja e personave të dënuar. Me këto përmisohet kaloria e ushqimit, kushtet higjienike dhe mbojtja në punë.

Faza e tretë – grupi i të dënuarve shpërndahej dhe secili person i dënuar tani fitonte një shtëpizë të veten me një sipërfaqe të caktuar të tokës, ku ai mund të mirrej me punë bujqësore duke kultivuar prodhime të ndryshme. Personat e dënuar duhet të përmbushnin një numër të caktuar të poenave për të arritur lirimin e tyre.

⁴⁵ Po aty, faqe 113

⁴⁶ Po aty, faqe 114

Ky sistem përveç anëve pozitive (krijimi i një atmosferë normale mes të burgosurve, vetëorganizimi, krijimi i shprehisë së punës) ka edhe anët negative sepse fitimi llogaritet si maksimal, shikohet vetëm ana materiale, si dhe të dënuarit kur nuk i arrijnë pikët e duhura binin në depresion)⁴⁷

1.8.6 Sistemi i Gjenevës

Edhe në këtë sistem personat e dënuar, gjatë mbajtjes së dënimit me burg kalojnë në tre faza: fazën e qelisë, fazën e burgut të përbashkët dhe fazën e daljes para kohe në liri.

Faza e qelisë është gati identike me sistemet tjera.

Faza e dytë është interesante sepse të dënuarit ndaheshin në grupe, nëngrupe, klasa dhe paralele. Kjo ndarje bëhej në bazë të kriterëve objektive dhe subjektive.

Faza e tretë e këtij sistemi ka pasur të bëjë më lirimin e personave të dënuar para kohe. Dmth lirimi me kusht, ku të dënuarit i kanë kaluar të gjitha fazat dhe sprovat, dhe vlersohet se janë përmisuar.⁴⁸

1.9.6 Sistemi bashkëkohor ose modern

Vetëm pas zhvillimit të shkencës së kriminologjisë dhe kërkimeve empirike kriminologjike të dukurisë së kriminalitetit, paraqiten kushte dhe rrethana më të volitshme të qasjes së luftimit dhe pengimit të kriminalitetit. Në shumë kërkime të kësaj problematike instistohet që heqja e lirisë-qëndrimi në burg mos të ndikojë në izolimin dhe shkatërrimin e jetës shpirtërore të të dënuarit. Sipas këtij sistemi për tu mbrojtur nga kriminaliteti, shoqëria patjetër duhet ti klasifikojë personat e dënuar. Në këtë drejtim flitet se sistemi modern aplikon disa faza karakteristike siç është faza e studimit dhe observimit të personalitetit të dënuarit, faza e tretmanit në insitucionin e përbashkët, e cila përfshin klasifikimin, individualizimin dhe procesin e riintegritit dhe faza e tretë që përfshin lirimin me kusht të personave të dënuar.⁴⁹

Faza e parë, sipas sistemit modern, fillon vrojtimin dhe studimin e personit të dënuar. Personi dënuar gjatë kësaj faze i nënshtrohet një studimi dhe analize të një ekipi të ekspertve të lëmenjëvë të ndryshëm shkencor. Duke aplikuar njohuritë shkencore nga lëmia e psikologjisë, sociologjisë, kriminologjisë, pedagogjisë dhe disiplinave të tjera, bëhet një njohje e tërësishme e personalitetit të të dënuarit. Në këtë mënyrë, personaliteti i të dënuarit inçizohet nga të gjitha aspektet pastaj, propozohet tretmani i cili duhet aplikuar ndaj tij.⁵⁰

Faza e dytë e sistemit modern-bashkëkohor është shumë e gërshetuar me një klasifikim të gjerë të personave të dënuar. Ky klasifikim mbështet në një varg kriteresh. Në rend të parë instistohet që

⁴⁷ Po aty, faqe 114

⁴⁸ Po aty, faqe 117

⁴⁹ Po aty, faqe 119

⁵⁰ Po aty, faqe 121

gjatë klasifikimit të personave të dënuar të vijnë në shprehje vetitë personale të cilat janë të rëndësishme për procesin e riedukimit dhe riintegritimit. Me interesim, angazhim, me punë, me përsosje dhe aftësim profesional, ata vetë mund të krijojnë kushte për të fituar një varg të drejtash dhe beneficimesh. Këto të drejta mund të jenë: e drejta në vizita, e drejta të dalë jashtë institucionit, e drejta për të vazhduar shkollimin e mesëm apo universitar, e drejta për shpërblim më të madh në punë, e drejta për pushime të jashtëzakonshme e deri te lëshimi me kusht para se të kaloj afati i dënimit. Të gjitha këto të drejta dhe beneficione mund të arrihen gjatë fazës së burgut të përbashkët.⁵¹

Faza e tretë e sistemit modern është lëshimi me kusht dhe ndihma postpenale ndaj të dënuarve. Lëshimi me kusht, sipas këtij sistemi është mjaft i ngjashëm me sistemin progresiv irlandez. E vetmja risi është se personat e dënuar të cilët lëshohen me kusht, u ofrohet një ndihmë dhe kujdes i veçantë, që ka të bëjë me sigurimin e punës, sigurimin e vendosjes, mbrojtjen shëndetësore dhe ndihma të tjera të cilat kanë për qëllim stabilizimin e tyre dhe pengimin e përsëritjes në sjelljet kriminale.⁵²

Në vazhden e përpjekjeve dhe ideve më të reja për përsosjen e sistemit të ekzekutimit të dënimit me burgim, sot jo vetëm në teori por edhe në praktikë, flitet për disa risi që janë duke u aplikuar në disa vende dhe janë në funksion të riedukimit dhe riintegritimit të plotë të personave të dënuar dhe të pengimit të kriminalitetit në përgjithësi. Kjo veçmas ka të bëjë me aplikimin e metodave dhe mjeteve më bashkëkohore të tretmanit ndaj personave të dënuar gjatë qëndrimit nëpër ente. Poashtu, këto risi kanë të bëjnë edhe me themelimin e disa institucioneve të tipit të veçantë, sidomos institucioneve të hapura, institucioneve vikende dhe institucioneve tjera, ku puna dhe jeta e personave të dënuar është shumë afër punës dhe jetës në liri.⁵³

Sipas këtij sistemi kërkohet që të vijnë në shprehje më tepër sanksionet dhe masat alternative të trajtimit të personave të dënuar. Përkundër aplikimit të masave të ndryshme që paraqiten si alternativë e dënimit me burgim, në shoqërinë bashkëkohore, fatkeqësisht numri i personave që gjenden duke vuajtur dënimet nëpër burgjet është shumë u madh.⁵⁴

Nga e gjitha kjo që u tha më lartë mendoj se burgjet në Republikën tonë janë më të përafërta me sistemin bashkëkohor, për arsye se edhe te ne qëllimi kryesor është risocializimi dhe riintegrimi dhe jo hakmarrja si në shumicën e sistemeve. Poashtu e përbashkët është edhe klasifikimi i të dënuarve, kyçja në punë dmth aftësimi fizik, lëshimi me kusht, ndihma postpenale etj.

⁵¹ Po aty, faqe 121

⁵² Po aty.

⁵³ Po aty.

⁵⁴ Po aty, faqe 122

1.7 Rregullat minimale standarde të OKB-së për trajtimin e të burgosurëve

Parimi themelor

1) Rregullat që vijojnë duhet të zbatohen në mënyrë të paanshme. Nuk duhet të bëhet asnjë dallim në trajtim të bazuar në një paragjykim, sidomos për shkak të racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, fesë, opinionit politik apo opinionit tjetër, të origjinës kombëtare ose shoqërore, të pasurisë, të lindjes ose të çdo situatë tjetër.

2) Madje është e udhës të respektohen besimi fetar dhe normat morale të grupit të cilit i përket i burgosuri

Lokalet e burgut

1) Qelitë ose dhomat e caktuara për izolim gjatë natës nuk duhet të kenë më shumë se një të burgosur. Në qoftë se, për arsye të veçanta, si për shembull: ngushticë e përkohshme, është e nevojshme që administrata qendrore e burgut të bëjë përjashtime nga ky rregull, do të duhet të evitohet që të strehohej dy veta për çdo qeli ose dhomë individuale.

2) Në rastet kur ka fjetire këto duhet të strehohen të dënuar të zgjedhur me kujdes dhe të njohur sit ë përshtatshëm për ti vendosur në kushte të tilla. Gjatë natës ata do ti nënshtrohen një mbikqyrjeje të rregullt, e cila do ti përshtatet tipit të burgut.

3) Lokalet e burgut dhe sidomos ato që janë të destinuara për strehimin e të burgosurve gjatë natës duhet tu përgjigjen kërkesave të higjienës, të marrin parasysh klimën, në mënyrë të veçantë hapësirën e ajrosur, sipërfaqen minimale, ndriçimin, ngrohjen dhe ajrimin.

4) Në çdo lokal ku të burgosurit duhet të punojnë ose jetojnë.

a) Dritaret duhet të jenë të medha aq sa i burgosuri të mund të lexojë e të punojë e të punojë në dritën natyrore; rregullimi i këtyre dritareve duhet të lejojë hyrjen e ajrit të freskët dhe kjo pavarësisht nga fakti nëse ka apo jo ajrim artificial.

b) Drita artificial duhet të jetë e mjaftueshme aq sa i burgosuri të ketë mundësi të lexojë dhe të punojë pa dëmtuar pamjen e tij.

c) Instalimet sanitare duhet ti lejojnë të burgosurit të përmbushë nevojat natyrore në çastin e duhur në një mënyrë të pastër e të përshtatshme.

ç)Instalimet e banjës e të dushit duhet të jenë të mjaftueshme në mënyrë që çdo i burgosur të ketë mundësi ti përdor në një temperaturë që ti përshtatet klimës dhe aq shpesh sa e kërkon higjiena e përgjithshme.

d)Të gjitha mjediset që frekuentohen rregullisht nga të burgosurit duhet të jenë të mbajtura në rregull të plotë dhe në pastërti.

Veshmbathja dhe shtresat

1) çdo i burgosur që nuk është i autorizuar të mbajë veshjen e vet vetjake duhet të pajiset me një veshje që ti përshtatet klimës dhe ti mjaftojë për të mbajtur atë në shëndet të mirë.

2)Të gjitha veshjet duhet të jenë të pastra dhe në gjendje të mirë.Veshjet e mbrendshme duhet të jenë të lahen aq shpesh sa është e nevojshme për ruajtjen e higjienës.

3)Në rastet e jashtëzakonshme kur i burgosuri del nga burgu për ndonjë qëllim të autorizuar,atij duhet ti lejohet të vejë veshjen e tij të vetjake,ose një veshje që të mos tërheqë ndonjë vëmendje të veçantë.

4)Kur të burgosurit lejohen të mbajnë veshjen e tyre vetjake duhet të merren masa,në çastin e hyrjes së tyre në institucion(burg),për të siguruar që veshja të jetë e pastër dhe e domosdoshme.

5)çdo i burgosur duhet të ketë dispozicion,në përputhje me zakonet locale ose nacionale,një shtrat të vetin individual si dhe shtresa të veta të mjaftueshme,të mbajtura mirë dhe të përtëritura me qëllim që të sigurohet pastërtia.

Ushqimi

1)çdo i burgosur duhet të marrë nga administrara në orët e zakonshme një ushqim të cilësisë së mirë,të përgatitur dhe të shërbyer mirë dhe që të ketë një vlerë ushqimore të mjaftueshme për të ruajtur shëndetin dhe forcat.

2)çdo i burgosur duhet të ketë mundësi të siguroj ujë të pijshëm kurdoherë që ka nevojë.

Shërbimet mjekësore

1)çdo instiucion penitensiar duhet të ketë në dispozicion një mjek të kualifikuar,i cili të ketë njohuri në psikiatri.Do të ishte e udhës që shërbimet mjekësore të organizoheshin duke qenë në kontakt të ngushtë me administratën e përgjithshme të shërbimit shëndetësor të një rrethin ose të gjithë vendit.Aty duhet të përfshihet edhe një shërbim psikiatrik për diagnostifikimin dhe,pot ë jetë nevoja,edhe për trajnimin e rasteve të anomisë mendore.

2)Për të sëmurët që kanë nevojë për kura të posaçme,duhet parashikuar transferimin në institucione penitensiare të specilizura ose në spitale civile.Kur trajtimi spitalor është i organizuar brenda institucionit të burgut.

3)çdo i burgosur duhet të ketë mundësi të kurohet nga një dentist i kualifikuar.

Disiplina dhe dënimet

Rendi dhe disiplina duhet të mbahen me vendosmëri,por pa bërë kufizime me shumë se sa është e nevojshme për ruajtjen e sigurisë dhe të një jete kolektive të organizuar mirë.

Asnjë i burgosur nuk mund të ushtrojë një pushtet disiplinor kur thirret të kryej ndonjë shërbim brenda një institucionit.

Ky rregull megjithatë nuk duhet të bëhet pengesë për funksionin e një sistemi që bazohet në vetqeverisje të mbrendshme.

Pikat e mëposhtme duhet të jenë gjithmonë të përcaktuara ose me ligj ose me një akt të autoritetit administrative kompetent.

Mjetet shtrënguese

Mjetet shtrënguese si hekurat,zinxhirët,këmishat të forcës nuk duhet të përdoren kurrë si sanksione.Zinxhirët dhe hekurat nuk duhet poashtu të përdoren si mjete shtrënguese.Mjetet e tjera shtrënguese nuk mund të përdoren veçse në rastet e mëposhtme:

a)si masë sigurie për të shmangur arratisjen gjatë një transferimi,me kusht që ato mjete të hiqen sapo i burgosuri del përpara një organi gjyqësor ose administrative.

b)Për arsye mjekësore me porosi të mjekut

c)Me urdhër të drejtorit,në qoftë se mjetet tjera për të mbajtur nën kontroll një të burgosur nuk kanë patur sukses,me qëllim që ai të mos mund të dëmtoj veten e tij e të tjerët ose të shkaktojë dëme:në këtë rast drejtori duhet të konsultojë urgjentisht mjekun dhe ti bëjë një raport autoritet administrative epror.

Informimi dhe e drejta e të burgosurëve për tu ankuar

çdo i burgosur kur hyn në burg duhet të ketë një informacion me shkrim mbi regjimin e të burgorëve të kategorisë së tij,mbi rregullat disiplinore të institucionit,mbi mjete qe janë të lejuara për tu informuar dhe për të formuluar ankesa,si dhe mbi çdo pikë tjetër që mund të jetë e

nevojshme për ti dhënë atij mundësinë të njohë të drejtat dhe detyrat dhe ti përshtaten jetës së institucionit.

2) Në qoftë se i burgosuri është analfabet ky informacion duhet ti jepet atij gojarisht.

3) I burgosuri duhet të ketë të drejtën, në çdo ditë pune, ti parashtojë kërkesa dhe ankesa drejtorit të institucionit ose nëpunësit që është autorizuar ta përfaqsojë.

4) Kërkesat mund ti parashtrohen edhe inspektorit të burgjeve gjatë një inspektimi. I burgosuri mund të bisedojë me inspektorin ose me çdo nëpunës tjetër të ngarkuar me inspektimin pa praninë e drejtorit ose të anëtarëve të tjerë të personelit të institucionit.

5) I burgosuri duhet të lejohet ti dërgojë pa censurë në përmbajtje por në një formë të përshtatshme, një kërkesë ose ankesë të administratës qendrore të burgjeve, organit gjyqësor ose çdo organi tjetër kompetent, në rrugën që përcaktohet nga rregullat e burgut.

6) Me përjashtim të rasteve kur një kërkesë ose ankesë është haptazi e tepruar dhe e pathemeltë, ajo duhet të shqyrtohet pa vonesë dhe të burgosurit duhet ti jepet një përgjigje brenda një afati të arsyeshëm.

Kontakti me botën e jashtme

1) Të burgosurit duhet të lejohen që nën mbikqyrjen e nevojshme të komunikojnë me familjen e tyre si dhe me ata miq të tyre të cilëve mund tu besohet në interval të rregullta, si me letërkëmbim ashtu duke prituri dhe vizita.

2) Të burgosurve që janë shtetas të një shteti të huaj duhet tu krijohen lehtësi të arsyeshme për të komunikuar me përfaqësuesit e tyre diplomatik e konsullar.

3) Për sa u përket të burgosurve shtetas të shteteve që nuk kanë përfaqësues diplomatikë ose konsullar në një vend, si dhe refugjatëve dhe personave pa shtetësi, duhet tu krijohen edhe atyre po ato lehtësi për tu drejtuar përfaqësuesit diplomatik të shtetit që mbikqyr intereset e tyre ose çdo autoriteti tjetër kombëtar apo ndërkombëtar që ka për detyrë ti mbrojë.

4) Të burgosurit duhet të mbahen rregullisht në dijeni të ngjarjeve më të rëndësishme qoftë nëpërmjet leximit të gazetave të përditshme, revistave ose të botimeve penitensiare ose çdo mjeti tjetër të ngjajshëm, të autorizuar ose të kontrolluar nga administrata.

Feja

1) Në qoftë se në burg ka një numër të mjaftueshëm të të burgosurish të një feje të vetme atëherë duhet të emrohet një përfaqësues i kualifikuar i kësaj feje pranë këtij burgu ose të dërgohet një fetar me mission të posaçëm. Kur numri i të burgosurve e justifikon dhe kur rrethanat e lejojnë, kjo lloj zgjidhje mund të parashikohej me orar të plotë shërbimi.

2)Përfaqsesi i kualifikuar i emërtuar ose i atashuar sipas paragrafit të 1 duhet të lejohet të organizojë periodikisht shërbesa fetare si dhe të bëjë,sa herë që është e lejuar,vizita baritore veçanërisht tek të burgosurit e fesë së tij.

3)E drejta për të hyrë në kontakt me një përfaqses të kualifikuar të një feje nuk duhet ti refuzohet asnjë të burgosuri.

4)çdo i burgosur duhet të lejohet,brenda mundësive,të përmbushë kërkesat e jetës së tij fetare,duke marrë pjesë në shërbesat e organizuara në burg dhe duke patur në dispozicion librat e formimit dhe të mësimit fetar që i përkasin fesë së tij.

Njoftimi i vdekjes,sëmundjes,transferimi etj

1)Në rast vdekjeje ose sëmundjeje të rëndë,të një aksidenti të rëndë ose të shërimit të të burgosurit në një institucion për të sëmurë mendor,drejtori duhet të informojë bashkëshorten në qoftë se i burgosuri është i martuar,ose njeriun më të afërt ose çdo person për të cilin i burgosuri ka kërkuar që të njoftohet.

2)I burgosuri duhet të njoftohet menjëherë për vdekjen ose sëmundjen e rëndë të njeriut të tij të afërt.Në rast se i afërmi është prekur nga një sëmundje e rrezikshme,i burgosuri duhet të autorizohet,kur rrethanat e lejojnë,të shkojë ta vizitojë qoftë i shoqëruar qoftë lirisht.

Transferimi i të burgosurve

1)Kur të burgosurit sillen në burg ose nxirren jashtë,ata duhet ti ekspozohen sa më pak pamjes së publikut dhe duhet të merren masa për ti mbrojtur nga sharjet,kureshtja e publikut dhe çdo lloj publiciteti.

2)nuk duhet të lejohet transportimi i të burgosurve në kushte të këqija ajrosje ose ndriçimi,sikurse nuk duhet të përdoren për këtë mjete që mund të shkaktojnë vuajtje fizike.

3)Transportimi i të burgosurve duhet të bëhet me shpenzimet e administratës dhe në kushte të barabarta për të gjithë.

Personeli i burgjeve

1)Personeli duhet të jetë në nivel intelektual të mjaftueshëm

2)Shërbimet e punonjësve shoqërorë,mësuesve dhe instruktorëve teknikë duhet të sigurohen në mënyrë permanente,por pa përjashtuar shërbimet e ndihmëse me orar të pjesshëm dhe të vullnetarëve.

3)Drejtori i burgut duhet të jetë mjaft i kualifikuar për detyrën e tij për nga karakteri ,aftësitë administrative,formimi përkatës si dhe për nga përvoja e tij në këtë fushë.

4) Drejtori dhe anëtarët tjerë duhet të flasin gjuhën e shumicës së të burgosurve, ose një gjuhë që të kuptohet nga shumica e tyre.

5) Kurdoherë që do të jetë e nevojshme të kërkohet ndihma e përkthyesit

6) Anëtarët e personelit të burgut duhet ti nënshtrohen një stërvitjeje fizike special që të mund ti vënë nën kontroll të burgosurit e dhunshëm.

Inspektimi

Inspektorët e kualifikuar dhe me përvojë, të caktuar nga një organ kompetent, duhet të kryejnë inspektimet e rregullta në burgjet dhe shërbimet në to. Ata duhet të kujdesen në mënyrë të veçantë që këto institucione të administrohen në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi dhe me qëllim që të arrihen objektivat e shërbimeve penitensiare dhe korrektuese.⁵⁵

Duke marrë për bazë këto parime, mund të krahasojmë gjendjen e burgjeve në Republikën e Maqedonisë, domethënë sa realisht aplikohen këto rregulla në burgjet tona. Unë personalisht kam vizituar burgun për të mitur në Ohër dhe burgun në Tetovë. Mjerisht, vetëm një pjesë e vogël e këtyre rregullave u përgjigjeshin burgjeve të lartpërmendura. Fillimisht do të ndalem tek burgu i të miturve në Ohër. Atje kushtet ishin minimale. Psikologja luante rol të shumfishtë, herë si arsimitare herë si psikologe e herë herë edhe si gardiane burgu. Higjiena nuk ishte aspak në nivel, ambienti ishte tejet i zymtë. Por jo vetëm ky, edhe burgu i Tetovës nuk ishte aspak më mirë. Thuaj se gati gati e njejtja gjendje. Higjien aspak, të burgosurit ankoheshin se edhe ushqimi nuk u servohet ashtu si duhet (me vitamine, kalori e proteina të mjaftueshme), gjithashtu ankoheshin edhe për klimën sidomos gjatë dimrit, se nuk u garantoheshte nxemje e mjaftueshme.

Nga ana tjetër burgu i Idrizovës është pothuajse nga burgjet më të njohura në Republikën tonë. Ky burg njihet si burg i mbipopulluar, ku të burgosurit tregojnë se si kanë fjetur në korridoret e këtij institucioni penitensiar. Se kushtet në burgjet e Maqedonisë vazhdojnë të jenë alarmante, këtë më së miri e tregojnë të burgosurit në Idrizovë. Sidomos kur temperaturat janë të ulëta, ndërsa mungon ngrohja e duhur. "Mezi arrijm të ngrohemi". Secilit të burgosur nga shtëpitë e tyre, familjarët u kanë sjellë batanije dhe jorgan. Nuk janë burgje të dënimit, por burgje të trishtimit. Ushqimi është i tmerrshëm, këtu kanë vetëm ata që nuk kanë asnjë të ardhur në familje. Ndihma mjekësore mungon, ndodh që në ditë të ketë një mjek, e ndonjëherë pritët me ditë për kontroll, shprehen të burgosurit. Vërejtjet e shënuara edhe më tutje janë problem serioz,

⁵⁵ Ragip Halili, Penologjia, Prishtinë 2011, faqe 284

veçanërisht në burgjet në të cilat vite me radhë nuk janë rinovuar fare, ndërsa mirëmbajtja e higjienës u është lënë vet personave të dënuar. Kur kësaj i shtohen edhe hapësirat e vjetra dhe të amortizuara për vendosje dhe mirëmbajtja e higjienës, atëherë konfirmohet edhe perceptimi për kapacitetet e këqija të vendosjes në burgje. Kushte modeste për vuajtjen e dënimit me burg sigurojnë vetëm pavijonet, repartet e reja të hapura dhe burgu i Kumanovës”, thonë nga Avokati i Popullit.⁵⁶



Burgu i Idrizovës

⁵⁶ <https://telegrafi.com/burgjet-ne-magedoni-kushte-te-mjerueshme/>

KAPITULLI I DYTË

2.1 Dënimi me burg në RM

Dënimi është e keqe e paramenduar dhe e qëllimshme që i shkaktohet kryerësit për veprën e kryer në kornizat e fajit për veprën e kryer.⁵⁷ Sipas dispozitave të ligjeve të Republikës së Maqedonisë për procedurë penale dhe ekzekutim të sanksioneve, gjykimeve dhe vendimeve hyjnë në fuqi kur nuk mund më tej të hidhen poshtë ankesat ose kur nuk janë të lejuara ankesat. Nëse nuk parashtrahet ankesë ose palët heqin dorë nga ankesa, vendimi bëhet i zbatueshëm me skadimin e afatit për ankesë.⁵⁸

KPM dallon burgim kohor të kufizuar dhe burgim të përjetshëm. Minimumi ligjor i dënimit kohor të kufizuar është tridhjetë ditë, ndërsa maksimumi ligjor është 20 vjet. Për veprat që është paraparë dënimi me burgim të përjetshëm mund të shqiptohet dënim deri 40 vjet. (n.35 p1) Me përcaktimin e këtillë të minimumit dhe të maksimumit ligjor, legjislacioni ynë afrohet kah orientimi humanitar i mënjanimet të privimit të gjatë nga liria (për kryerjen e veprës), si dhe mbylljen e shkurtër që është e papërshtatshme për risocializimin e kryerësit (në disa vende minimum ligjor është i fiksuar në një ditë). Burgimi shqiptohet në vite, muaj të plotë, kurse deri gjashtë muaj edhe në ditë të plota (n.35 p.5)⁵⁹

Burgimi i përjetshëm është dënim i veçantë që mund të përshkruhet për format e rënda të veprave penale të paramenduar për të cilat është paraparë dënim me burgim prej 20 vjetësh. (n.35 p.2) Ky dënim nuk mund të përshkruhet si dënim i vetëm kryesor (n.35 p.3). Nga dispozita e mëhershme del se ajo mund të përshkruhet si dënim alternative vetëm me dënimin me burgim deri në 20 vjet. Alternativa për burgimin e përjetshëm është edhe dënimi me burgim deri në 40 vjet. (n.35 p.4). Burgimi i përjetshëm u paraqit në legjislacionin tonë penal në vitin 1996 për të plotësuar një zbrazëtitirë e krijuar me ndalesë kushtetuese për shqiptimin e dënimit me vdekje.⁶⁰

Vuajtja e dënimit

Dënimi me burgim mbahet në institucione të hapura ose të mbyllura (n.35 p.7) Llojet e enteve, organizimi dhe mënyra e vuajtjes së dënimit janë të rregulluara me LES (ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve) të vitit 2006, si dhe me ndryshimet dhe plotësimin e ligjit në vitin 2010. Korniza juridike i përfshin edhe standardet ndërkombëtare për sjellje me personat e dënuar, statumi i të cilëve ka filluar me rregullat standard minimale për sjellje me të burgosur e miratuar në Kongresin e Parë të OKB-preventiva e krimit të Gjenevës më 1955. Zhvillimi i normave ndërkombëtare dhe i standardeve sot e ka arritur shkallën e normativës ndërkombëtare komplekse në të gjitha aspektet e sistemit të burgut: hapsirën, higjienën, shëndetsinë dhe

⁵⁷ Vllado Kambovski, Ismail Zejneli, E drejta penale pjesa e përgjithshme, Tetovë 2018, faqe 250

⁵⁸ <http://vertetmates.mk/si-caktohen-denimet-ne-republiken-e-maqedonise/>

⁵⁹ Vllado Kambovski, Ismail Zejneli, E drejta penale pjesa e përgjithshme, Tetovë 2018, faqe 256

⁶⁰ Po aty, faqe 257

standardet tjera ,regjistrimin,kategorizimin e personave të dënuar,trajtimin punues,ushqimin,sportin etj.Për sistemin tonë penitenciar janë relevante edhe rregullat evropiane të burgut nga Komiteti i Ministrave të KE i vitit 1987.⁶¹

Si qëllim kryesor i vuajtjes së dënimit me burgim LES e definon risocializimin,që si nocion përveç riedukimit e përfshin edhe adaptimin social të personit të dënuar,përgatitjen e tij për përkrahje shoqërore dhe sjellje në liri.Si qëllim kryesor i vuajtjes së dënimit me burgim LES e definon risocializimin,që si nocion përveç riedukimit përfshin edhe adaptimin social të personit të dënuar ,përgatitjen e tij për përkrahje shoqërore dhe sjellje në liri.⁶²

Format dhe trajtimet janë:puna,trajtimi edukativ dhe shkollor,si dhe organizimi kulturor,sportive dhe format tjera të organizimit të kohës se lirë.Metodat e trajtimit përfshijnë diapason të gjerë të individuale(biseda,këshilla)ose metoda gruporetë sjelljes me persona të gjykuar(këshillim grupor,psikoterapi grupore etj).⁶³

Gjykata kompetente për shqiptimin e sanksioneve është gjykata sipas vendbanimit/vendqëndrimit të personit të dënuar. Sipas Ligjit për ekzekutim të sanksioneve, gjykata e shkallës së parë është e detyruar që ta kryejmë menjëherë, dhe më së voni në afat prej tre ditësh kur vendimi hynë në fuqi. Procedura për referimin e të dënuarve në burg është urgjente Procedura për ekzekutimin e të gjithë gjykimeve në pjesën e dënimeve e udhëheq gjykatësi për sanksione, person të cilin duhet ta ketë çdo gjykatë themelore. Ai mes tjerash vendos për:⁶⁴

*Referencë për dhënien e dënimit me burg

*Zvarritje të vuajtjes së dënimit me burg

*Ndërprerje të vuajtjes së dënimit dhe hyrjen në fuqi ndalesën për vuajtje të dënimit me burg

* Vjetërsin e ekzekutimit të dënimit ose ndalesa për vuajtjen e dënimit për shkak të vdekjes së personit të gjykuar,informon gjykatën përkatëse për shkak të marrjes së vendimit të duhur

Gjykata për ekzekutim të sanksioneve është e detyruar që të ketë qasje ndaj ekzekutimit të sanksioneve menjëherë pas marrjes së vendimit. Gjykata, në rastin kur i gjykuari nuk u paraqit në ekzekutimin e dënimit me burg në ditën e caktuar, menjëherë do t'i jep urdhër Ministrisë së Punëve të Brendshme për arrestim të personit të gjykuar, po ashtu, do të kërkojë që përderisa personi i gjykuar fshihet ose gjendet në arratisje, organi të nxjerr ose lëshon urdhër arresti për gjetje të personit të gjykuar për të vuajtur dënimin me burg të caktuar.⁶⁵

⁶¹ Po aty,faqe 257

⁶² Po aty,faqe 258

⁶³ Po aty.

⁶⁴ <http://vertetmates.mk/si-caktohen-denimet-ne-republiken-e-maqedonise/>

⁶⁵ <http://vertetmates.mk/si-caktohen-denimet-ne-republiken-e-maqedonise/>

2.2AKTI DREJTUES

Personit të gjykuar personalisht i dorëzohet akt drejtues në të cilën është shënuar dita kur duhet të paraqitet në ndërtesën e përcaktuar të burgut. Me aktin drejtues personi i gjykuar paralajmërohet se përderisa nuk paraqitet në ditën e caktuar, në burg do të futet me forcë.⁶⁶

Personi i gjykuar prej momentit të marrjes së aktit drejtues për shkuarjen në burg deri me datën kur është shënuar akti për fillim të realizimit të dënimit duhet të ketë më së paku tetë ditë, më së shumtë 13 ditë kohë. Gjykatësi për ekzekutimin e sanksioneve me dorëzimin e aktit drejtues personit të gjykuar njëkohësisht njofton edhe burgun për ditën se kur i dënuari duhet të paraqitet. Nëse personi i gjykuar, në pajtim me aktin drejtues, nuk paraqitet në ditën e caktuar për kryerjen e dënimit me burg, burgu për duke mos e zgjatur do të njoftoi gjykatësin për ekzekutim të sanksioneve.⁶⁷

EKZEKUTIMI I DËNIMIT ME BURG MUND TË SHTYHET:

- Përderisa zgjat sëmundja, gjegjësisht mjekimi, nëse shtyrja kërkohet për shkak se personi i gjykuar gjendet në mjekim për shkak të ndonjë sëmundje më të rëndë akute ose varësia.⁶⁸

Për shkak të arsyes specifike (hospitalizim për shkak të sëmundjes së rëndë akute ose varësisë) Ligji lejon lutje për shtyrjen e fillimit të ekzekutimit të dënimit mund ta vuaj partneri i tij, familjar nga gjaku në linjën e parë, prindi adoptues, fëmija i adaptuar, vëllau, motra ose kujdestari. Personi i gjykuar të cilit i është shtyrë vuajtja e dënimit për këtë shkak është i detyruar që në çdo 30 ditë të dorëzojë fakt të vlefshëm për gjendjen e tij shëndetësore.⁶⁹

- Më së voni për tre muaj, nëse shtyrja kërkohet për shkak të vdekjes ose ndonjë sëmundje në familjen e afërt të personit të gjykuar; nëse shtyrja është e nevojshme për shkak të ekzekutimit ose përfundimit të punëve urgjente përgjysmë ose sezonale, ose punë të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore, ose ndonjë fatkeqësie tjetër, dhe në familjen e të dënuarit nuk ka forcë të mjaftueshme punëtore; nëse shtyrja kërkohet për shkak se personi i gjykuar është i detyruar që të kryejë një punë të caktuar të cilën e ka filluar tashmë, dhe për shkak të mos kryerjes së asaj pune do të ketë dënim më të madh; dhe nëse është e nevojshme që personi i gjykuar për kohë të caktuar të kujdeset për edukimin dhe ruajtjen e fëmijëve ose kujdesin e personave të pafuqishëm për të cilët është i detyruar t'i kryejë, sipas mendimit të organeve për mbrojtje sociale në komunën në të cilën fëmijët ose ato persona banojnë ose kanë vendqëndrimin.⁷⁰

⁶⁶ <http://vertetmates.mk/si-caktohen-denimet-ne-republiken-e-maqedonise/>

⁶⁷ Po aty.

⁶⁸ Po aty.

⁶⁹ Po aty.

⁷⁰ Po aty.

Pas kryerjes së vitit shkollor nëse shtyrja personit të gjykuar i është e nevojshme për shkak të përfundimit të vitit shkollor ose gjashtë muaj nëse shtyrja personit të dënuar i është e nevojshme për shkak të provimeve për të cilët është përgatitur.⁷¹

2.3 Pozita dhe organizimi i sistemit gjyqësor në Republikën Maqedonisë

Në kuadër të ndarjes së funksioneve shtetërore, funksioni gjyqësor është lënë në kompetencë të gjykatave. Pushteti gjyqësor është kompetent për zgjidhjen e kontesteve juridike, të tregojë se çfarë është në pajtim më të drejtën në rastin konkret. Funksioni gjyqësor, si funksion gjyqësor i zgjidhjes së kontesteve të cilat paraqiten ndërmjet pjesëtarëve të një shteti, është i vjetër. Por, pushteti gjyqësor si institucion shtetëror daton më vonë. Gjykatat në RM-së gjykojnë në bazë të Kushtetutës, ligjeve dhe në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në pajtueshmëri me Kushtetutën dhe sigurojnë zbatimin e të drejtës dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. *Objektivat dhe funksionet e gjyqësisë përfshijnë:*⁷²

-zbatimin e paanshëm të së drejtës, pa marrë parasysh pozitën dhe cilësinë e palëve; përparimin e mbrojtjes dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut;

-sigurinë juridike dhe krijimin e kushteve për çdo njeri të jetojë i sigurt në kuadër të zbatimit të së drejtës. Gjykata vendos sipas procedurës së shkruar ligjore për: të drejtat e qytetarëve dhe interesat të bazuara juridike;

-kontestet ndërmjet qytetarëve dhe subjekteve të tjerë juridik; veprat e dënueshme dhe veprimet e tjera që me ligj janë lënë nën kompetencën e gjykatës.⁷³

Organizimi i gjyqësisë në Republikën e Maqedonisë është unitar. Gjykatat e jashtëzakonshme janë të ndaluara. Llojet, kompetencat, themelimi, anulimi, organizimi dhe përbërja e gjykatave është rregulluar me Ligjin për gjykatat . Ky është ligj organik, ligj që sillet me shumicë të cilësuar prej dy të tretave të votave nga i gjithë numri i deputetëve. Vlen të theksohet fakti se gjykatat gjykojnë në bazë të parimit të kologjialitetit, parimi i zgjedhjes dhe revokimit-shkarkimit të gjyqtarit, parimi i pjesmarrjes së porotës, parimi i pavarësisë dhe paanshmërisë, parimi shumëshkallësh, si dhe parimi i çmuarjes së lirë të provave.⁷⁴

Në sistemin gjyqësor, pushtetin gjyqësor e ushtrojnë gjykatat:

Themelore

Gjykatat e apelit

Gjykata e lartë e RM-së dhe Administrative

⁷¹ Po aty.

⁷² http://aa.mk/WBStorage/Files/poglavje10_AL.pdf

⁷³ Po aty.

⁷⁴ Po aty.

2.4 Gjykatat themelore krijohen për territore të caktuara. Në RM ekzistojnë 72 gjykata themelore. Gjykatat themelore themelohen për një ose më shumë komuna dhe kanë kompetencë lëndore themelore ose të zgjeruar. Në kuadër të disa gjykatave themelore me kompetencë të zgjeruar (në gjykatat themelore në Manastir, Tetovë, Shkup I dhe Shkup) themelohen seksione (degë) gjyqësore të specializuara që do të veprojnë në konteste të llojeve të caktuara. Gjykatat themelore gjithashtu mund të kenë seksione gjyqësore, mund të gjykojnë jashtë selisë së gjykataës, si dhe mund të kenë ditë gjyqësore jashtë selisë së gjykatës (neni 23 I LGjRM).⁷⁵

Gjykatat e përmendura më sipër (përveç Gjykatës Administrative) gjykojnë çështjet penale. Mirëpo duhet theksuar se, përkundër faktit se këto gjykata gjykojnë çështje penale, megjithatë organizimi i tyre është i rregulluar në bazë të parimit të gjyqësisë së unisuar, kështu që një gjykatë të njëjtë gjykohen çështjet penale dhe ato civile.⁷⁶

Gjykatat e apelit krijohen për territoret e më shumë gjykatave themelore. Në RM ekzistojnë 4 Gjykata apeli: në Manastir, Shkup, Gostivar dhe në Shtip. Gjykatat e apelit janë kompetente të vendosin mbi ankesat kundër vendimeve të gjykatave themelore, të vendosin për mosmarrëveshjen e kompetencës ndërmjet gjykatave themelore në territorin e tyre dhe të kryejnë veprime të tjera të përcaktuara me ligj.⁷⁷

Gjykata supreme e RM-së ushtron pushtetin gjyqësor në të gjithë territorin e Republikës. Ajo është gjykata më e lartë në Republikë dhe e siguron unitetin në zbatimin e ligjeve nga ana e gjykatave. Selia e saj është në Shkup.⁷⁸

⁷⁵ http://aa.mk/WBStorage/Files/poglavje10_AL.pdf

⁷⁶ Ismail Zejneli, Ejup Sahiti, E Drejta e procedurës penale në Republikën e Maqedonisë, faqe 69, Shkup 2017

⁷⁷ http://aa.mk/EBStorage/Files/poglavje10_AL.pdf

⁷⁸ Po aty.




2.5 ANKETË

Unë personalisht kam realizuar një anketë të shkurt me qytetarët dhe pyetjet që i parashtrova ishin këto:

a) A mendoni se gjykatat në vendin tonë e kryejnë punën e tyre në mënyrë korrekte?

b) Po të ishit ju të dënuar a mendoni se do tju jepet dënimi i merituar?

c) A janë të korruptuara gjykatat tona?



Përgjigjet që morra ishin me sa vijon:

65% e qytetarëve nuk i besojnë punës së gjyqësorit të vendit tonë, ndërsa 35% e tyre po.

60% e qytetarëve nuk mendojnë se do tu shqiptohet dënimi adekuat, ndërsa 40% e tyre po.

70% e qytetarëve mendojnë se gjykatat janë të korruptuara, ndërsa 30% e tyre jo.

2.6 Dënimi me burg në Gjykatën e Kërçovës

Gjykata e Kërçovës është gjykatë e cila deri në vitin 2006 ka gëzuar kompetencë të zgjeruar, por pastaj i merren kompetenca të caktuara dhe prej këtij viti e deri më sot ajo paraqitet vetëm si gjykatë themelore. Mirëpo prej vitit 2020 pritet që ti kthehen përseri kompetencat e marrura. Ashtu siç u theksua më parë sot ajo numëron këto të drejta:

1. vendos për vepra penale për të cilat është paraparë si dënim kryesor dënimi me burgim deri në 5 vjet, nëse për disa vepra penale nuk është paraparë kompetencë e gjykatës tjetër.
2. vendos për veprat penale për të cilat me ligj të veçantë është përcaktuar kompetencë e gjykatës me kompetencë themelore.
3. është e autorizuar të zbatoj hetim apo veprime hetuese për vepra që janë në kompetencë të saj
4. vendos për të gjitha llojet e kundërvajtjeve përveç kundërvajtjeve të cilat janë vënë me ligj në kompetencë të organit të administratës shtetërore ose organit apo organizatës që kryen funksione publike si dhe
5. vendos për ankesa dhe prapsime juridike për të cilat janë kompetente këto gjykata.⁷⁹

Unë personalisht kam studiuar nga afër statistikën e gjykatës themelore të Kërçovës ku sëbashku me një ekip të autorizuar nga vet kryetari i gjyqit më mundësuan që të elaboroj dhe të nxjerr rezyme mbi të dhënat e të gjykuarve me burg.

Dhe, të dhëna statistikore të marra nga gjykata e Kërçovës lidhur me shqiptimin e dënimit me burg prej vitit 2013-2018 janë me sa vijon:

Në vitin **2013** gjykata themelore e Kërçovës nga 271 lëndë penale 36 prej tyre ju është shqiptuar dënim me burg.

Në vitin **2014** gjykata themelore e Kërçovës nga 328 lëndë penale 37 prej tyre ju është shqiptuar dënim me burg.

Në vitin **2015** gjykata themelore e Kërçovës nga 234 lëndë penale 30 prej tyre ju është shqiptuar dënim me burg.

Në vitin **2016** gjykata themelore e Kërçovës nga 268 lëndë penale 29 prej tyre ju është shqiptuar dënim me burg.

Në vitin **2017** gjykata themelore e Kërçovës nga 189 lëndë penale 21 prej tyre ju është shqiptuar dënim me burg.

⁷⁹ Ligji mbi gjykata në R.M nr 58/2006

Në vitin **2018** gjykata themelore e Kërçovës nga 214 lëndë penale 25 prej tyre ju është shqiptuar dënim me burg.

Nga kjo mund të përfundojmë se përgjatë intervalit kohor 2013-2018 në gjykatën themelore të Kërçovës janë gjithsej **1504** lëndë penale nga të cilat vetëm 178 prej tyre u është shqiptuar **DËNIM ME BURG**.



Sqarim:

Në këtë diagram është paraqitur numri i personave të dënuar në gjykatën e Kërçovës në bazë të vitit. Sipas ngjyrës shihet qartë se viti 2014 shënon numër më të lartë të personave të dënuar me burg, pastaj pason viti 2013, dhe 2018 ndërkaq vitet 2015, 2016, 2017 shënojnë rënie të personave të dënuar.

KAPITULLI I TRETË

3.1 Struktura e personave të dënuar

3.1.1 Moshë

Lidhja ndërmjet moshës dhe kriminalitetit është studiuar shumë kohë më parë. Këteleja (Quetele) e vlerëson moshën si një ndër faktorët më të rëndësishëm që ndikon në tendencat e krimit. Tendencat më të theksuar të krimit zhvillohet në proporcion me intenzitetin e forcës fizike dhe pasionin e personit.⁸⁰

Të dhënat e shumta statistikore flasin se me veprime dhe sjellje kriminale merren persona të moshave të ndryshme. Moshë e kryerësve të veprave penale, përkatsisht sjelljeve kriminale, mund të ndahet sipas përcaktimeve ligjore pozitive. Sipas ligjeve pozitive penale të vendeve të ndryshme, moshë e kryerësve të veprave penale, ndahet në moshë të personave të mitur dhe personave të rritur. Mirëpo, brenda këtyre dy ndarjeve kryesore, kemi edhe ndarje tjera. Moshë e mitur ndahet në të mitur të rinj, e cila përfshin moshën prej 14-16 vjet dhe në të mitur të rritur që përfshin moshën prej 16-18 vjet. Ndërkaq, si moshë e rritur konsiderohet moshë prej 18 e deri në vdekje të individit. Nëse shikohen të dhënat statistikore, gjyqësore dhe të dhënat nga kërkimet empirike kriminologjike në botë, vërehet se moshat më prezente në veprimet kriminale janë moshat prej 25-30, pastaj grupi i moshës 30-50 dhe më pak grupi i moshës mbi 60 vjet.⁸¹

3.1.2 Gjinia

Ekziston një përshtypje e përgjithshme, në bazë të të dhënave të statistikës kriminale dhe praktikës gjyqësore se kriminaliteti është një dukuri tipike e gjinisë mashkullore. Sipas kërkimeve kriminologjike të bëra në shumë vende të botës në SHBA, Gjermani, Francë, Angli, Japoni dhe shumë vende të tjera të botës gjinia mashkullore ka dominuar në mënyrë absolute. Gjatë vitit 2003 sipas shënimeve statistikore të gjykatave komunale të Kosovës mbi kryerësit e veprave penale del se 95% të këtyre veprave i kryejnë personat e gjinisë mashkullore, e vetëm 5% të gjinisë femërore. Sipas të dhënave statistikore, nga literatura kriminologjike, në vendet e ndryshme përqindja e pjesëmarrjes në kriminalitet të përgjithshëm e personave të gjinisë femërore sillel nga 8-10%. Karakteristika e kriminalitetit të femrave është edhe fakti se ato më tepër marrin pjesë në kryerjen e krimeve si ndihmëse, shtytëse e më pak si kryerëse të drejtëpërdrejta apo organizatore të krimeve të caktuara.⁸²

⁸⁰ Prof. Ismail Zejneli, Delikuenca e të miturve, Tetovë-Prishtinë 2018, faqe 114

⁸¹ Prof. Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2011, faqe 129

⁸² Po aty, faqe 131

| Viti 2013 | | | | | | | |
|------------|----------|-------|---------------------|------------|---------------------------|------------|----------------------|
| Lënda | Gjinia | Mosha | Dënimi | Vendbanimi | V.penale | Recidivist | Etniteti |
| K.br 2/13 | Mashkull | 33 | 3 muaj | Fshat | Neni 386, p 2 | Po | Shqiptar |
| K.br 58/13 | Mashkull | 55 | 8 muaj | Qytet | Neni 235, p 1 | Po | Rom |
| K.br117/13 | Mashkull | 28 | 1 vit | Qytet | n.236,p 1 | Po | Rom |
| K.br115/13 | Mashkull | 45 | 3 muaj | Qytet | n.235,p 1 | Po | Maqedon |
| K.br64/13 | Mashkull | 27 | 1 vjet | qytet | Neni 236 paragrafi (1) | Po | Maqedon |
| | Femër | 26 | {dënim me kusht} | fshat | | Jo | Maqedon |
| | Mashkull | 29 | | qytet | | Po | Maqedon |
| K.br86/13 | Mashkull | 25 | 6 muaj | Qytet | n.236 p1 | Po | Rom |
| K.br93/13 | Mashkull | 44 | 3 muaj | Fshat | n.132 p1 | Po | Maqedon |
| K.br103/13 | Mashkull | 43 | 1v. 6 muaj | Qytet | n.236 p1 | Po | Rom |
| K.br155/13 | Mashkull | 29 | 1vjet | qytet | n.236 p1 | Po | Shqiptar |
| | Mashkull | 28 | 8 muaj | fshat | | Jo | Shqiptar |
| | Mashkull | 27 | 1 vit | qytet | | Po | Shqiptar |
| K.br110/13 | Mashkull | 47 | 6 muaj | qytet | n.236 p1 | Po | Rom |
| | Mashkull | 43 | 6 muaj | qytet | | Po | Rom |
| K.br16/13 | Mashkull | 33 | 6 muaj | Qytet | n.215 p2 | Po | Maqedon |
| K.br4/13 | Mashkull | 25 | 3 muaj | Qytet | n.236 p.1 | Jo | Rom |
| K.br24/13 | Mashkull | 68 | 1v.6 muaj | Fshat | n.300 p.4 n.301 p.2 | Jo | Maqedon |
| K.br10/13 | Mashkull | 54 | 3 muaj | Qytet | Neni 386 p2 | Po | Turk |
| K.br8/13 | Mashkull | 55 | 3 muaj | Qytet | n.386 p1 | Po | Rom |
| K.br 44/13 | Mashkull | 41 | 3 muaj | Qytet | n.235 p1 | Po | Rom |
| K.br59/13 | Mashkull | 55 | 8 muaj | Qytet | n.235 p1 | Po | Rom |
| K.br 72/13 | Mashkull | 43 | 1v. 6 muaj | Qytet | n.236 p1 | Po | Rom |
| K.br 65/13 | Mashkull | 25 | 6 muaj | Qytet | n.236 p1 | Jo | Rom |
| K.br 95/13 | Mashkull | 34 | 3 muaj | Qytet | n.235 p1 | Po | Rom |
| K.br 75/13 | Mashkull | 43 | 2 vjet | Qytet | n.247 p3 | Po | Turk |
| K.br151/13 | Mashkull | 39 | 3 muaj | Qytet | n.235 p1 | Po | Rom |
| K.br207/13 | Mashkull | 45 | 6 muaj | Fshat | n.236 p1 | Po | Shqiptar |
| K.br225/13 | Mashkull | 47 | 8 muaj | Qytet | n.198 p1 | Po | Rom |
| K.br172/13 | Mashkull | 42 | 6 muaj | Qytet | n.236 p1 | Po | Maqedon |
| K.br69/13 | Mashkull | 45 | 1 vjet | Fshat | n.236 p1 | Po | Shqiptar |
| K.br231/13 | Mashkull | 48 | 1 vjet | Qytet | n.215 p2 | Po | Turk |
| K.br61/13 | Mashkull | 53 | 1v. 6muaj | Qytet | n.216 p1 | Po | Maqedon Maqedon |
| | Mashkull | 34 | 1v.6muaj | | | | |
| K.br240/13 | Mashkull | 24 | 6muaj | fshat | n.236 p1 | Po | Shqiptar Shqiptar |
| | Mashkull | 31 | 1 vit | fshat | | | |
| K.br183/13 | Mashkull | 39 | 6 muaj | Qytet | n.131 p1 | Po | Shqiptar |
| K.br236/13 | Mashkull | 41 | 1 vit | Qytet | n.236 p1 | Po | Shqiptar |
| K.br263/13 | Mashkull | 55 | 1v.4muaj | Qytet | n.236 p1 | Po | Rom |

| | | | | | | | |
|------------|----------|----|----------|-------|-----------|----|----------|
| K.br140/13 | Mashkull | 44 | 3 muaj | Fshat | n.382 p1 | Po | Shqiptar |
| K.br84/13 | Mashkull | 31 | 3muaj | qytet | n.242 p1 | Po | Maqedon |
| | Mashkull | 35 | 3muaj | qytet | | | |
| K.br207/13 | Mashkull | 45 | 6muaj | Fshat | n.236 p1 | Po | Shqiptar |
| K.br251/13 | Mashkull | 33 | 3vjet | Fshat | n.236 p 1 | Po | Shqiptar |
| | Mashkull | 31 | 1vj.6muj | | | | Shqiptar |

Tab.1

VITI 2013-Nga kjo tabelë mund të rezymojmë se në vitin 2013 janë kryer këto vepra penale:

Vepra penale më e shpeshtë në territorin e komunës së Kërçovës është vjedhja e rëndë (16) ku pason pastaj vjedhja(6),dhuna(3)prodhimi i paautorizuar dhe lëshimi në qarkullim i drogave narkotike,substancave psikotrope dhe prekursorëve(2)ku më pas vijon edhe mundësimi I përdorimit të drogave narkotike(1),pjesmarrja në rrahje(1),mashtrim(1),marrja e të miturit(1),lëndim I rëndë trupor(1) dhe rrezikimi i sigurisë(1) vepra të rënda kundër sigurisë së njerëzve dhe pasurisë në trafik(1)mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqsi trafiku(1)marrja e automjetit (1)pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare (1).

Përsa i përket etnitetit 14 janë shqiptar ,11 janë maqedon rom 16 dhe turq 3.Mosha mesatare është 39 vjet.Dominon gjinia mashkullore 44 ndaj 1

Përsa i përket vendbanimit veprat e sipërpërmendura janë kryer më shumë në vende urbane 33 në krahasim me ato rurale 11 Gjithashtu fakt interesant është edhe recidivizmi ku vetëm 5 prej 44 janë jo recidivista.

| Viti 2014 | | | | | | | |
|------------------|---------------|--------------|---------------|-------------------|-----------------|-------------------|-----------------|
| Lënda | Gjinia | Mosha | Dënimi | Vendbanimi | V.penale | Recidivist | Etniteti |
| K.br12/14 | Mashkull | 40 | 3 muaj | Qytet | n.236 p1 | Po | Maqedon |
| K.br8/14 | Mashkull | 41 | 1v.3muaj | Qytet | n.236 p1 | Po | Turk |
| K.br45/14 | Mashkull | 24 | 1v.6muaj | Fshat | n.236 p1 | Po | Shqiptar |
| K.br50/14 | Mashkull | 46 | 3 muaj | Qytet | n.236 p1 | Po | Maqedon |
| K.br37/14 | Mashkull | 59 | 1vjet | Qytet | n.215 p2 | Po | Rom |
| K.br43/14 | Mashkull | 39 | 1 vjet | Qytet | n.215 p2 | Po | Shqiptar |
| K.br104/14 | Mashkull | 46 | 3 muaj | Fshat | n.242 p1 | Po | Shqiptar |
| K.br47/14 | Mashkull | 41 | 2 vite | Fshat | n.236 p1 | Po | Shqiptar |
| K.br90/14 | Mashkull | 24 | 2 vit | Fshat | n.236 p1 | Po | Shqiptar |
| K.br94/14 | Mashkull | 46 | 1 vit | Fshat | n.288 p3 | Po | Shqiptar |
| K.br292/14 | Mashkull | 47 | 1 vit | Qytet | n.235 p1 | Po | Rom |
| K.br263/14 | Mashkull | 41 | 1 vit | Qytet | n.216 p1 | Po | Maqedon |
| K.br274/14 | Mashkull | 43 | 3 muaj | Qytet | n.236 p1 | Jo | Maqedon |
| K.br82/14 | Mashkull | 46 | 2 vite | Qytet | n.235 p1 | Po | Rom |
| K.br118/14 | Mashkull | 24 | 9 muaj | Fshat | n.235 p1 | Po | Shqiptar |
| K.br226/14 | Mashkull | 55 | 3 muaj | Qytet | n.235 p1 | Po | Maqedon |
| K.br327/14 | Mashkull | 24 | 6 muaj | Qytet | n.215 p1 | Po | Shqiptar |

| | | | | | | | |
|------------|----------|----|----------|-------|----------|----|----------|
| K.br109/14 | Mashkull | 80 | 9 muaj | Fshat | n.235 p1 | Jo | Shqiptar |
| K.br46/14 | Mashkull | 47 | 2 vite | Qytet | n.236 p1 | Po | Rom |
| K.br225/14 | Mashkull | 30 | 1v.6muaj | Qytet | n.300 p4 | Po | Shqiptar |
| K.br214/14 | Mashkull | 44 | 1 vit | Fshat | n.300 p4 | Jo | Maqedon |
| K.br211/14 | Mashkull | 40 | 6 muaj | Qytet | n.236 p1 | Po | Maqedon |
| K.br261/14 | Mashkull | 40 | 2 vite | Qytet | n.236 p1 | Po | Maqedon |
| | Mashkull | 40 | 1 vit | Qytet | n.236 p1 | Po | Maqedon |
| K.br256/14 | Femër | 36 | 3 muaj | Qytet | n.202 p1 | Po | Maqedon |
| K.br321/14 | Mashkull | 28 | 6 muaj | Fshat | n.215 p2 | Po | Shqiptar |
| K.br98/14 | Mashkull | 31 | 6 muaj | Fshat | n.236 p1 | Po | Shqiptar |
| K.br242/14 | Mashkull | 49 | 3 muaj | Qytet | n.202 p2 | Po | Maqedon |
| K.br278/14 | Mashkull | 33 | 3 muaj | Fshat | n.382 p2 | Po | Shqiptar |
| K.br239/14 | Mashkull | 47 | 2 vite | Qytet | n.236 p1 | Po | Rom |
| K.br241/14 | Mashkull | 24 | 3muaj | Fshat | n.236 p1 | Jo | Shqiptar |
| | Mashkull | 25 | 3muaj | Fshat | n.236 p1 | Jo | Shqiptar |
| K.br208/14 | Mashkull | 33 | 3 vite | Fshat | n.236 p1 | Jo | Shqiptar |
| | Mashkull | 35 | 3vite | Fshat | n.236 p1 | Jo | Shqiptar |
| K.br262/14 | Mashkull | 38 | 2vite | Fshat | n.236 p1 | Jo | Shqiptar |
| K.br243/14 | Mashkull | 23 | 3 vite | Fshat | n.236 p1 | Po | Shqiptar |
| | Mashkull | 31 | 3 vite | Fshat | n.236 p1 | Po | Shqiptar |
| | Mashkull | 35 | 1 vit | Fshat | n.236 p1 | Jo | Shqiptar |
| | Mashkull | 42 | 2 vite | Qytet | n.236 p1 | Po | Rom |
| K.br295/14 | Mashkull | 70 | 6 muaj | Fshat | n.300 p4 | Jo | Shqiptar |
| K.br328/14 | Mashkull | 43 | 2 vite | Qytet | n.235 p1 | Po | Shqiptar |
| K.br293/14 | Mashkull | 38 | 6 muaj | Qytet | n.297 p1 | Jo | Turk |
| K.br217/14 | Mashkull | 61 | 3 muaj | Qytet | n.186 p4 | Jo | Maqedon |

Tab.2

Në bazë të tabelës numër 2 (VITI 2014) vërejmë se:

Përsa i përket gjinisë ,ashtu si edhe në vitin 2013 në kryerjen e veprave penale dominon gjinia mashkullore 42 ndërkaq femra ka vetëm 1,gjithashtu edhe në vitin 2014 numri i recidivistëve është tejet i lartë 31 ndërsa 12 nuk janë.Lidhur me vendbanimin,më i shprehur është qyteti 27,ndërsa nga fshati 16.Mosha mesatare është 28 vjec.Vlen të theksohet fakti se 12 janë maqedon 2 turq,23 janë shqiptar dhe 6 rom.Ndërsa lloji dominues i veprës penale është vjedhja e rëndë (16) pastaj(6) vjedhje, *prodhimi i paautorizuar dhe lëshimi në qarkullim i drogave narkotike,substancave psikotrope dhe prekusorëve(4)*ku më pas vijon edhe *mundësimi i përdorimit të drogave narkotike(1),shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm(1) marrja e automjetit (1)Vepra të tënda kundër sigurisë së njerëzve dhe pasurisë në trafik(3)mosdhënia e mjeteve për jetesë (2)pengimi i personave zyrtar në kryerjen e veprimit zyrtar(1)rrezikimi i sigurisë në trafik(1)dhunë (1).*

| Viti 2015 | | | | | | | |
|------------|----------|-------|-----------|------------|----------|------------|----------|
| Lënda | Gjinia | Mosha | Dënimi | Vendbanimi | V.penale | Recidivist | Etniteti |
| K.br23/15 | Mashkull | 33 | 2 vite | Fshat | n.236 p1 | Po | Shqiptar |
| K.br43/15 | Mashkull | 47 | 3 muj | Fshat | n.235 p3 | Po | Shqiptar |
